

GJYKATA E QARKUT PEJË
P.nr. 329/09
Data 19 Nëntor 2009

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA E QARKUT NË PEJË, në kolegjin e përbërë nga Gjykatësi Ndërkombëtar Gianfranco Gallo kryetar i trupit gjykues, Gjykatësi Ndërkombëtar Ferdinando Buatier de Mongeot dhe Gjykatësi Kosovar Hasan Shala anëtar të kolegjit, të asistuar nga Valentina Gashi në procesverbal, në rastin penal ndaj të akuzuarit

IDRIZ GASHI, i lindur me 1 Maj 1960 në Lutogllavë , mashkull, emri i babait Bajram, mbiemri i vajzërisë së nënës Hanife Xhurxhevic, Shqipëtar Kosovar, pseudonimi Galan, banues në Snodropsgatan 28, 21527 Malmoe, Sweden, adresa e përkohshme Rr. Eqrem Qabej, Blloku 3, # 13, profesioni këshilltar financiar, aktualisht në arrest shtëpiak në Hotelin Grand, Prishtinë, apartamenti nr. 714,

I akuzuar sipas Aktakuzës PP. Nr. 36/06 të datës 8 Shkurt 2007 dhe e futur në dosje në Gjykatë në të njëjtën ditë, për veprën penale siç vijon,

Krime Luftë ndaj Popullatës Civile në kundërshtim me Nenin 142 të Kodit Penal të RSFJ sepse,
në mëngjesin e 12 Gushtit 1998, Sanije Balaj, një grua Shqipëtare-Kosovare, është marrë në pyetje nga anëtarët e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK) që kontrollonin rajonin e fshatit Baran. Ajo pastaj është dërguar nga Idriz Gashi (i njohur si Galani) dhe ke një rajon i pyllëzuar i njohur si "Lugu i Isufit" ku Idriz Gashi ka shtëinë në të dhe e ka vrarë. Në Luginë e Isufit, në afërsi të fshatit Vranoc, Komuna e Pejës, me 12 Gusht 1998.

Pas mbajtjes së shqyrtimeve gjyqësore publike me 21, 29 dhe 30 Tetor 2009 dhe me 12, 17 dhe 19 Nëntor 2009 në prezencë të:

- të akuzuarit Z. Idriz Gashi dhe avokatit mbrojtës Z. Beke Lajqi;
- Prokurorit Publik të EULEX-it Z. Robert Dean;
- Palës së dëmtuar

pas shqyrtimit nga ana e trupit gjykues dhe votimit të mbajtur me 19 Nëntor 2009, të bazuar në Nenin 391, paragrafi (1) të KPPK,

me 19 Nëntor, sipas Nenit 392 Paragrafi (1) i KPPK, shpallë publikisht dhe në prezencë të të Akuzuarit, Prokurorit Publik të EULEX-it, siç vijon

AKTGJYKIM

Idriz Gashi

është

FAJTOR

për **Krime Luftë** ndaj Popullatës Civile, në kundërshtim me Nenin 142 të Kodit Penal të RSFJ-së, Neni 3 dhe 147 i Konventës së 4 të Gjenevës dhe Neni 4 i Protokollit Shtesë II të Konventës së Gjenevës, në lidhje me vrasjen Sanije Balajt, të kryer në Lugun e Isufit, në afërsi të fshatit Vranoc, Komuna e Pejës, me 12 Gusht 1998.

PRANDAJ, i akuzuari,

DËNOHET

Me katërbëdhjetë (14) vite burgim për veprë penale të Krimeve të Luftës ndaj Popullatës Civile në kundërshtim me Nenin 142 të Kodit Penal të RSFJ-së, Nenin 3 dhe 147 të Konventës së 4 të Gjenevës dhe neni 4 i Protokollit Shtesë II të Konventës së Gjenevës;

Koha e kaluar në paraburgim nga i pandehuri (përfshirë kohën e kaluar në paraburgim në Suedi në pritje të ekstradimit në Kosovë për veprën penale të cekur më lartë) dhe në arrest shtëpiak do të kreditohet ndaj dënimit, sipas Nenit 391 paragrafi (1), Nënparagrafi 5, Neni 531, Par. 4 dhe neni 278 Par. 7 i KPPK.

I akuzuari do të kompenzoj koston e shqyrtimeve penale sipas Nenit 102 paragrafi (1) të KPPK me përjashtim të shpenzimeve për përkthime. Një vendim i veçantë për koston do të merret nga gjykata kur të sigurohen të dhënat, sipas Nenit 100 Paragrafi (2) i KPPK-së.

ARSYETIMI

A. HISTORIA PROCEDURALE - AKTAKUZA

Me 08 Shkurt 2007, Prokurori Publik i Unmik-ut dorëzoi aktakuzën PP. No.36/2006 në Gjykatën e Qarkut në Pejë, kundër të pandehurit Idriz Gashi, duke akuzuar atë për veprë penale të Krimeve të Luftës ndaj Popullatës Civile, në kundërshtim me nenin 142 të Kodit Penal të RSFJ-së dhe Vrasje e Rëndë në kundërshtim me Nenin 30 par. 2 pika 1, 2 dhe 5 të Kodit Penal të Kosovës.

Sipas aktakuzës, në mëngjesin e 12 Gushtit 1998, Sanije Balaj, një grua Shqipëtare-Kosovare, është marrë në pyetje nga Ushtria Çlirimtare e Kosovës (UÇK) që kontrollonin rajonin e Fshatit Baran, pastaj ajo është dërguar nga Idriz Gashi (i njohur

si Galani) dhe i në një rajon të pyllëzuar të njohur si "Lugu i Isufit", në afërsi të fshatit Vranoc, Komuna e Pejës, ku Idriz Gashi ka shtënë në të dhe e ka vrarë. Idriz Gashi e kishte akuzuar Sanije Balajn të ishte në bashkëpunim me forcat armiqësore Serbe.

Pas shqyrtimit të konfirmimit me 23 Mars 2007, gjykatësi Konfirmues i Gjykatës së Qarkut në Pejë lëshoi aktvendimin PP. Nr. 36/2006, duke hedhur poshtë aktakuzën në lidhje me veprën penale të *Vrasjes së Rëndë* në kundërshtim me nenin 30 par. 2, pika 1, 2 dhe 5 të Kodit Penal të Kosovës, ndërsa ajo konfirmoi aktakuzën për veprë penale të *Krime Lufte kundër popullatës civile* në kundërshtim me Nenin 142 të Kodit Penal të RSFJ.

Shqyrtimi kryesor (numri i rastit P. 537/07) është mbajtur në godinën e Gjykatës së Qarkut në Pejë me 22 Qershor 2007, dhe i pandehuri është gjetur fajtor dhe dënuar me pesëmbëdhjetë vite burgim.

Aktgjykimi është ankuar në kohë nga i pandehuri. Gjykata Supreme gjeti që ¹ është caktuar gabimisht nga gjykata e shkallës së parë si një dëshmitar, ndërsa duhej të ishte caktuar si një dëshmitar kooperues pasi ende kishte veprime hetuese ndaj tij për të njëjtën vrasje. Prandaj pasi nuk kishte elemente të nevojshme vërtetuese për të mbështetur deklaratën akuzuese kundër të pandehurit (posaçërisht dëshmitë dhe u gjetën të jenë të mjegulluara dhe jo në gjendje të sigurojnë një vërtetim të tillë). Prandaj Gjykata Supreme me 02.06.2009 përmes vendimit n. Ap. Kz. 465/08, anuloi aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë dhe dërgoj dokumentat e rastit në Gjykatën e Qarkut në Pejë për rigjykim. Për më tepër me një aktvendim të ndarë, Gjykata Supreme zëvendësoi paraburgimin me arrest shtëpiak.

B. KOMPETENCA E GJYKATËS

1. Procedura, Kompetenca dhe Përbërja e trupit gjykues e Gjykatës së Qarkut në Pejë.

Sipas Nenit 23, paragrafi 1 i KPPK, Gjykata e Qarkut duhet të ketë kompetencë të gjykojë në shkallë të parë vepra penale të dënueshme me më së paku pesë vite burgim ose burgim me afat të gjatë.

Në rastin aktual i akuzuari është akuzuar për Krime Lufte kundër popullatës civile në kundërshtim me Kodin Penal të Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë (RSFJ KP) neni 142, e dënueshme me burgim jo më pak se pesë (5) vite dhe jo më shumë se njëzet (20) vite. Prandaj Gjykata e Qarkut në Pejë e ka çështjen – lëndën për të gjykuar rastin.

Veprat penale sipas aktakuzës janë kryer në afërsi të fshatit Vranoc, Komuna e Pejës, e cila është brenda territorit të Qarkut të Pejës. Prandaj, sipas Nenit 27, par. 1 i KPPK, Gjykata e Qarkut në Pejë ka kompetencë territoriale të gjykojë rastin aktual.

Sipas nenit 3 të Ligjit mbi Jurisdikcionin, Përzgjedhjen e Rasteve, Dhënjën e Rasteve Gjykatësve dhe Prokurorëve të EULEX-it në Kosovë, Gjykatësit e EULEX-it të

caktuar për seancë penale do të kenë jurisdiksion dhe kompetencë mbi çdo rast të hetuar apo të ndjekur penalisht nga Prokurorët Special të Republikës së Kosovës.

Rasti aktual është hetuar dhe aktakuza është bërë nga Prokurorët Special të Kosovës, prandaj sipas Nenit 4.7 të Ligjit mbi Jurisdiksionin, kolegji gjykues i Gjykatës së Qarkut në Pejë është në përbërje të një kolegji të kombinuar nga dy Gjykatës të EULEX-it dhe një Gjykatës Vendor.

Asnjëra palë nuk e kundërshtoi përbërjen e kolegjit.

2. Shqyrtimi Kryesor

Shqyrtimi kryesor është mbajtur publikisht me 21, 29, 30 Tetor, 10, 12, 17 dhe 19 Nëntor 2009, në prani të të akuzuarit Idriz Gashi, avokatit mbrojtës Bekë Lajçi, Prokurorit Publik Special Robert Dean dhe Shaban Balaj një nga palët e dëmtuara. Sipas nenit 15 të KPPK, përkthyesit ndërkombëtar përkthyen seancën gjyqësore dhe të gjithë dokumentet në lidhje me gjykimin nga Anglisht në Shqip dhe në të kundërtën, sipas nevojës.

C. PËRMBLEDHJE E DËSHMIVE TË PARAQITURA

1. Gjatë seancave të shqyrtimit gjyqësor janë pyetur dëshmitarët, siç vijojnë:

- a) [] i marrur në pyetje me 30 tetor 2009
- b) [] i marrur në pyetje me 10 Nëntor 2009
- c) [] i marrur në pyetje me 10 Nëntor 2009
- d) [] i marrur në pyetje me 12 Nëntor 2009
- e) [] i marrur në pyetje me 17 nëntor 2009
- f) [] i marrur në pyetje me 19 Nëntor 2009

2. Deklaratat, raportet e policisë dhe dëshmitë tjera dokumentare janë lexuar gjatë seancave gjyqësore.

2.a) Dëshmitë dokumentare dhe raportet

Gjatë shqyrtimit kryesor, dokumentet siç vijojnë më poshtë janë lexuar si dëshmi sipas nenit 367 të KPPK.

- Raporti i policisë pa datë, hartuar nga Abedin Musa SHPK
- Raporti i policisë i datës 27.04.2005
- Raporti i policisë i datës 03.07.2005
- Raporti i policisë i datës 01.08.2005
- Raporti i policisë i datës 03.08.2005
- Raporti i policisë i datës 09.12.2005
- Raporti i autopsisë dhe rapoti i ADN-së
- Raporti ballistik
- Koleksion i fotografive dhe rezultatet

- Fotografi të siguruara nga i pandehuri
- Fotografia e Sanije Balajt
- Harta e rajonit
- Procesverbali i inspektimit të vendit dhe fotografitë e vendit të datës 30 Maj 2007
- Procesverbali i inspektimit të vendit të datës 14 Qershor 2007
- Letra e Idriz Gashit dërguar Prokurorit e datës 16 Nëntor 2006.

2.b) Deklaratat

Sipas Nenit 368, Par. 1, n. 3, në bazë të konsenzusit të palëve (shiko procesverbalin e seancës së mbajtur me 21 Tetor 2009), deklaratat siç vijojnë më poshtë u lexuan si dëshmi, duke zëvendësuar ekzaminimin e drejtpërdrejtë të dëshmitarëve të më poshtë shënuar:

- Deklarata dhënë Policisë Hetuese me 10 Maj 2005
- Deklarata dhënë Prokurorit me 22 Nëntor 2006
- Dëshmia dhënë para trupit gjykues me 17 Maj 2007
- Deklarata dhënë Policisë Hetuese me 01 Nëntor 2002
- Deklarata dhënë Policisë Hetuese me 06 Qershor 2005
- Deklarata dhënë Policisë Hetuese me 16 Shtator 2005
- Deklarata dhënë Prokurorit me 14 Shkurt 2006
- Dëshmia dhënë para trupit gjykues me 10 Maj 2007
- Deklarata dhënë Policisë Hetuese me 21 Tetor 2002
- Deklarata dhënë Policisë Hetuese me 26 Prill 2005
- Dëshmia dhënë para trupit gjykues me 09 Maj 2007
- Deklarata dhënë Policisë Hetuese me 21 Tetor 2002
- Deklarata e dhënë Policisë Hetuese me 26 Prill 2005
- Dëshmia e dhënë para trupit gjykues me 09 Maj 2007
- Deklaratë e shkruar vetë nga me 28 Shtator 2002
- Deklarata e dhënë Policisë hetuese me 02 Tetor 2002
- Dëshmia e dhënë para trupit gjykues me 09 Maj 2007
- Dëshmia e dhënë para trupit gjykues me 17 Maj 2007
- Dëshmia e dhënë para trupit gjykues me 14 Qershor 2007
- Dëshmia e Sylë Berisha-Janushi dhënë para trupit gjykues me 24 Maj 2007

D. REKONSTRUKSIONI FAKTIK I NGJARJEVE

Në pjesën që vijon të arsyetimit, deklaratat të ndryshme do të paraqiten në adresim të ngjarjeve më të rëndësishme të rastit aktual.

Nisja e Sanije Balajt nga Strellci.

Sipas dëshmisë së me 12 Gusht 1998 Sanije Balaj i ka thënë atij se dëshironte të shkonte në Pejë për të blerë një telefon. Në mëngjesin e asaj dite

... kërkoj nga kushërinjtë e tij ... dhe ... të cilët ndaluan në shtëpinë e tij në Strello, që të marrin motren e tij Sanijen dhe ta dërgojnë në Pejë. Ata e bënë këtë dhe vazhduan në fshatin Baran ku ishte vendosur shtabi i UÇK-së¹.

... konfirmon se me 12 Gusht 1998 në mes orës 8.00 dhe 9.00 në mëngjes ka shkuar në shtëpinë e ... në një makinë Zastava të ngarë nga ... Ata kishin planifikuar që të shkonin në Rosuje për të shoqëruar një djalë të vogël, ... pas udhëzimeve të babait të tij. Ata poashtu çuan me makinë Sanijen pasi ajo donte të shkonte në Pejë².

... dëshmoi pak a shumë në të njëjtën vijë dhe dha disa detaje shtesë: me 12 Gusht 1998, rreth orës 09.30 në mëngjes ai shkoi ke shtëpia e ... në një Zastavë të kuqe me ... dhe ... Ata ishin duke shkuar të dërgojnë ..., djali i axhës së tyre ... në Rosuje siç ishin udhëzuar nga babai i djalit. Në shtëpinë e ... Sanije Balaj ju bashkua atyre, pasi ajo dëshironte të blente disa gjëra ushqimore në Pejë dhe ata ishin duke shkuar në drejtim të Rosujes³.

Sipas të pandehurit Idriz Gashi, në mëngjesin e 12 Gushtit 1998, pasi kaloi natën me ... dhe ... ai shkoi në Shtab në Baran me të dy së bashku në një makinë Golf të kuq. Ai përmendi se qëllimi i tij ishte të shkonte në Gllogjan, mirëpo nuk e shpjegoi se pse u ndal në Baran dhe nuk vazhdoi për në Gllogjan⁴.

Arritja në Baran. Sanije Balaj merret nga policia ushtarake në mënyrë që të intervistohet.

... deklaroi se rrugës për në Rosuje, në fshatin Baran ku ishte e vendosur policia ushtarake, pesëdhjetë ose njëqind ushtarë i ndaluan ata. Ata kishin të veshura uniforma siç i përshkruan ai të kishin "ngjyra ushtarake"⁵. Me rastin e marrjes në pyetje gjatë ekzaminimit me 9 Maj 2007, ai specifikoi që " në përgjithësi ushtria dhe ushtarët kishin uniformë të gjelbërt dhe pjesa tjetër dhjetë përqind kishin të veshur të zeza". Në deklaratën e tij para policisë ai përmendi " një grup i armatosur në uniforma, me emblema të UÇK-së".

... shtoi se ai e njohu ... nga fshati Vranoc, ... nga fshati Zllapek dhe ... vëllau i ... në mesin e njerëzve që i ndaluan ata. Ata deklaruan se kishin për qëllim të marrin në pyetje Sanije Balajn dhe prandaj e nxorrën nga makina dhe e çuan në drejtim të kazermës ushtarake ku ishte vendosur shtabi. Ata lejuan vetëm ... që të shoqëron Sanije Balajn deri te shtabi i UÇK-së në Baran. Pas 15 deri 20 minuta ... u kthye te makina dhe sygjeroi që të dërgojnë djalin dhe pastaj të kthehen për Sanijen. Sipas ... dhe ... kishin të veshura uniforma të zeza, por nuk i kujtohej se çka kishte të veshur.

¹ Dëshmia para trupit gjykues, 9.5.2007, faqe 6.

² Dëshmia para trupit gjykues, 9.5.2007, faqe 22.

³ Dëshmia para trupit gjykues, 9.5.2007, faqe 29.

⁴ Deklarata para trupit gjykues, 24.5.2007, faqe 13 dhe 20.

⁵ Dëshmia para trupit gjykues, 9.5.2007, faqe 26.

⁶ Dëshmia para trupit gjykues, 9.5.2007, faqe 27.

deklaroi se në Baran afër shkollës, kishte kazermë ushtarake ose vend kampi⁷ dhe ushtarë në rrugë poashtu. Në deklaratën e tij dhënë policisë ai deklaroi se në shkollë ishte "komanda e UÇK-së" dhe ushtarët kishin "emblema të UÇK-së". Ata ishin ndaluar nga [redacted] i cili tha se kishte një pyetje për Sanije Balajn. Sanije Balaj dhe [redacted] iu afruan një Mercedesi Benz 200 të bardhë dhe ecën për pesë minuta. [redacted] insistoi që të shkon me ta, por ushtarët e ftuan të presë. Më specifikisht, [redacted] informoi [redacted] se ata nuk do ta lejojnë Sanije Balajn që të largohet nga vendi, pasi ajo duhej të merrej në pyetje. Në ekzaminimin e tij me 9 Maj 2007, [redacted] specifikoi se në atë moment ai nuk e dinte se pse Sanije Balaj ishte marr, por e kuptoi më vonë se "emri i saj ishte në librin e bashkëpunëtorëve me forcat armiqësore".

[redacted] shkoi pas [redacted] dhe Sanijes deri te një ndërtesë afër shkollës, por ishte ndaluar të hynte në ndërtesë nga disa ushtarë të cilët i thanë to largohet dhe shtoi se [redacted] u largua dhe përgjegjësi që u mendua se do të marr në pyetje Sanijen. [redacted] pa kur [redacted] morri një fletore nga makina dhe e dëgjoi [redacted] kur i tha Sanijes: "Ti je e kërkuar dhe duhet të vish me ne". [redacted] deklaroi se në ndërtesë së bashku me Sanijen ishin [redacted] dhe [redacted]. Pas afër njëzet minuta, një mbikëqyrës ushtarak ([redacted]) iu afrua ndërtesës dhe tha se ai duhet të intervistoj Sanijen dhe kërkoj nga [redacted] të largohet dhe të kthehet pas 30 minuta. Ai pastaj hyri në dhomë. Sipas [redacted] dhe [redacted] u urdhëruan që të largohen nga vendi dhe tre ushtarë mbetën me [redacted]. Dëshmitari pastaj u largua⁸. Gjatë ekzaminimit të tij me 9 Maj 2007, dëshmitari specifikoi se në atë kohë nuk e ka njohur [redacted], por e kuptoi emrin e tij nga [redacted] kur [redacted] ishte duke pyetur për fatin e Sanijes. Dëshmitari shtoi se gjatë vizitës që [redacted] i bëri familjes Balaj, disa ditë pas zhdukjes së Sanijes, [redacted] kishte deklaruar se ai nuk kishte të bënte asgjë me atë se çka ndodhi dhe se Sanija ishte marr nga një ushtarë i njohur si Galani.

[redacted] dëshmoi se në mëngjesin e 12 Gushtit 1998, ai dhe [redacted] (komandanti kryesor në Baran) ishin në zyrën e komandantit brenda objektit të shkollës në Baran. [redacted] dhe [redacted] u paraqitën dhe thanë se kishin marr disa të dyshimtë të cilët ishin duke bashkëpunuar me Serbët. Ata kërkonin që dikush të i intervistonte ata. [redacted] ishte zgjedhur për shkak të përvojës si oficer policie. [redacted] shoqëroi [redacted] dhe [redacted] deri te vendi ku ishte duke u mbajtur Sanije Balaj, dhe pasi e panë atë e kuptuan se e njohin fytyrën e saj, por nuk e dinte emrin e saj⁹.

Sa i përket kësaj, [redacted] në dëshminë e tij të dhënë me 16 Maj 2007, deklaroi se e kishte njohur Sanije Balajn për një kohë të gjatë. Ai e kishte njoftuar atë në restorantin e vëllaut të tij gjatë 1993-1994, kur ajo ishte mysafir në restorant me vëllaun e saj [redacted]. Me 12 Gusht 1998, [redacted] ka deklaruar se ka qenë jashtë shtabit të kazermës ushtarake në fshatin Baran. Ai e ka parë Sanije Balajn të shoqëruar nga dy oficerë në drejtim të shtabit të policisë ushtarake. [redacted] nuk

⁷ Dëshmia para trupit gjykues, 9.5.2007, faqe 29.

⁸ Dëshmia para trupit gjykues, 9.5.2007, faqet 29-30 dhe deklaratat në polici me 21.10.2002 dhe 26.4.2005.

⁹ Dëshmia para trupit gjykues, 10.5.2007, deklarata në polici me 6.7.2005, deklarata para prokurorit me 14.2.2006.

i kishte njohur dy oficerët¹⁰. Pesë apo gjashtë minuta më vonë ai ka parë kushërinjtë e saj dhe duke pritur atë në një kiosk. Ai deklaroi se nuk e din nëse apo e morrën në pyetje atë. Por sipas tij, ishte ai i cili e shoqëroi atë dhe e sjelli në zyrën e policisë ushtarake¹¹.

deklaroi se me 12 Gusht 1998 ai ishte me një grup të njerëzve në Shtabin në Baran, në mes tyre ishte . Ai ishte në detyrë atë ditë. Rreth orës 9.00 ose 10.00 në mëngjes ai ka parë një grua duke hyrë në shtab me një grup prej 5-6 burrash. Pas 20 apo 30 minuta ai e ka parë atë duke dalë nga shtabi me një grup të burrave, në mes tyre ishte një person me pseudonimin "Galan". Ai e njohu Galanin pasi ishte hera e dytë që e kishte parë atë, hera e parë ishte në Vranoc një apo dy ditë më herët. Në këtë pikë është e duhur të raportohet një shkëputje e ekzaminimit të të bërë me 30 Tetor 2009:

Kryetari i Trupit Gjykses: Dua të kthehem në momentin kur ti e ke parë për herë të parë këtë person Galanin. Në atë deklaratë me 13 Dhjetor 2002 dhënë policisë kur unë të ballafaqova para 10 minutash ju thatë se nuk kishte pyetje para se të përfundonish.

: Në lidhje me çka?

Kryetari i trupit Gjykses: Kur unë të thash se i keni thënë policisë se e keni parë Sanije Balajn duke dalë nga shkolla me Galanin dhe thatë se nuk ju kujtohej pyetja apo ndoshta ishte pak më ndryshe; tani a është e qartë për ju se çka isha duke thënë?

: Po.

Kryetari i Trupit Gjykses: Tani kemi një pjesë tjetër të deklaratës; pyetja në deklaratë ishte: "kur e keni parë Sanijen për herë të parë dhe si e njeh atë?". Ju keni thënë se nuk e njihni atë por e keni parë për herë të parë duke dalë nga shkolla fillore me Galanin. Ju keni thënë se e keni parë Galanin një apo dy ditë para ngjarjes në shtabin në Vranoc.

: Unë poashtu kam thënë se e kam parë Galanin një herë në Vranoc një ditë më parë dhe kurrë më.

Kryetari i Trupit Gjykses: Ju e keni parë Galanin për herë të parë në Vranoc dhe për herë të dytë në fshatin Baran duke dalë nga shkolla me një grup të njerëzve së bashku me Sanije Balajn?

: Nuk mund të them se ishte duke e shoqëruar atë.

Kryetari i Trupit Gjykses: E keni parë për herë të dytë duke dalë nga shkolla dhe afër tij ishte Sanije Balaj.

: Po.¹²

Marrja në pyetje e Sanije Balajt nga

Sipas dëshmisë së dhënë nga , e kishte lutur që të marr në pyetje vajzën dhe prandaj ai kishte shkuar së bashku me dhe në shkollë ku Sanija ishte duke u mbajtur. Pasi arriten në dhomën ku Sanija

¹⁰ Dëshmia para trupit gjykses me datën 12.11.2009, faqe 10:

Kryetari i Trupit Gjykses: I dini emrat e këzre dy oficerëve të policisë?

Avni Krasniqi: Këta emra nuk i di. Ne nuk ishim të interesuar në emrat e këtyre ushtarëve posaqërisht apo të ndonjë ushtari tjetër...

¹¹ Dëshmia para trupit gjykses me datën 12.11.2009.

¹² Dëshmia para trupit gjykses, 30.10.2009, faqe 14.

ishite duke qëndruar, ai kishte marr asaj letërnjoftimin dhe e kishte pyetur: "Ku je duke shkuar, pasi ata të kan ndaluar dhe janë duke thënë se diçka nuk është në rregull me ty sepse nuk je duke e marr rrugën më të shkurtë në Pejë, por je duke shkuar përmes Rosujes". Ai shtoi: "Më e keqja është se në rastin tënd këta djem thojnë se ti je duke bashkëpunuar me Serbët". Sanije Balaj është përgjegjur: "Unë nuk e di se çka janë duke thënë këta djem, nuk e di. Çfarë mund të ju thëm është destinimi im, ku jam duke shkuar" (dëshmia e [redacted] 10 Maj 2007, faqe 7). Sipas [redacted] Sanija është përgjegjur se ajo ishte duke shkuar përmes Rosujes në Klicinë ku ishte duke e pritur tezja/halla që të shkojnë në Pejë për të blerë një telefon pa tel. Dyshimet u shtuan sepse ajo donte të kalonte një rajon Serb që të shkon në Pejë kur atje kishte rrugë më të sigurt për të shkuar atje. Ajo donte të kalonte fshatin Klicinë për të shkuar në Pejë dhe një "stacion policor famëkeq ishte i vendosur në atë fshat, i drejtuar nga paramilitarë të cilët ishin duke kryer masakra" (deklarata e [redacted] 14 Shkurt 2006, faqe 6).

[redacted] deklaroi se gjatë marrjes në pyetje, [redacted] dhe [redacted] intervenuan disa herë, duke akuzuar Sanije Balajn se nuk është duke e treguar të vërtetën, dhe që është bashkëpunëtore e Serbisë dhe që ishte duke udhëtuar të takon Serb.

[redacted] kërkoi nga ta që të mos ndërhyjnë dhe në fund ju tha të largohen nga dhoma. Në të vërtetë, sipas [redacted] kur [redacted] ka ardhë së pari në zyrën e [redacted] ka deklaruar se ka dyshime se Sanije Balaj ishte duke bashkëpunuar me një Serb, Qorroviq Dragan (shiko dëshminë e [redacted] 10 Maj 2007, faqe 16).

Për më tepër, gjatë intervistës, të dy [redacted] dhe [redacted] kontrolluan bllokun e shënimeve të Sanijes dhe thanë: "e shih se çka ka këtu". Sanije Balaj ka shpjeguar se në bllok kishte emra dhe adresa të njerëzve që ajo i kishte njohur. Sipas [redacted], në bllok të shënimeve kishte disa emra të Serbëve, por tha që intervista në tërësi zgjati pesë minuta dhe pavarësisht ishte shumë e shkurtër¹³.

[redacted] deklaroi se Sanije Balaj ishte dërguar te policia ushtarake dhe ishte marr në pyetje pasi me siguri ishte e dyshimtë. Ai e mohon të ketë qenë i pranishëm në dhomë kur ishte marr në pyetje Sanije Balaj. Ai ka thënë se ka qenë jashtë ndërtesës dhe ka mundur të shohë brenda në dhomë përmes dritareve të ndërtesës dhe se Sanije Balaj ishte së bashku me [redacted] dhe nuk mund të shihte askënd tjetër. Ai ishte jashtë kur Idriz Gashi kaloi pranë tij. Ai nuk e kishte parë atë duke hyrë në ndërtesë, por e kishte parë atë brenda në dhomë përmes dritareve të ndërtesës¹⁴.

Prania e të pandehurit në intervistën e Sanije Balajt.

Sipas [redacted], gjatë intervistës, përveç [redacted] dhe [redacted] aty ishte një person i tretë i pranishëm i cili qëndroi i heshtur. Me 16.9.2005, kur është marr në pyetje nga policia, [redacted] identifikoi në një renditje fotografike fotografinë e Idriz Gashit si personi i tretë i pranishëm gjatë intervistës së Sanijes dhe poashtu shtoi

¹³ Deklarata e Cuf Krasniqit, 14 Shkurt 2006, faqe 9.

¹⁴ Dëshmia para trupit gjykues me datën 12.11.2009, faqe 11.

se ky person thirrej Galan ose Galan (në intervistë ka specifikuar se në atë kohë ai nuk e kishte ditur pseudonimin e tij dhe se e kishte kuptuar atë më vonë).¹⁵ Në intervistë para Prokurorit me 14 Shkurt 2006, ka specifikuar se ishte Galani vetë ai i cili e informoi në lidhje me emrin e tij dhe fshatin e origjinës (Lutogllavë, në komunën e Pejës). Në intervistën e njëjtë ka shtuar se ai kishte dëgjuar poashtu se i pandehuri kishte jetuar në Suedi dhe kur ishte kthyer e kishte prezentuar veten si Officer i Lartë Galani. Ai konfirmoi se i pandehuri ishte i pranishëm në intervistë.¹⁶

Gjatë ekzaminimit para trupit gjykues me 10 Maj 2007, ka deklaruar se i pandehuri nuk kishte uniformë në ditën që intervista u bë. Ai nuk ishte i interesuar të kuptoj se kush ishte personi i tretë i pranishëm në intervistë dhe nuk i kushtoi vëmendje uniformës "sepse disa veshnin uniformë, disa jo". Duke u ballafaquar në bazë të deklaratës së parë të dhënë prokurorit, të cilit i ka thënë se ky person kishte të veshur uniformë të kamufluar, ai elaboroi dhe tha "*Me kamuflim unë kam menduar ngjyra të përziera dhe jo të dukshme siç janë të zezat apo të gjelbërtat. Ishte e kombinuar me shirita dhe njolla*".¹⁷ nuk e kishte ditur nëse Sanije Balaj e kishte njohur të pandehurin, por i kujtohej se ajo kishte deklaruar se e njihje dhe.¹⁸

I pandehuri Idriz Gashi ka deklaruar se në mëngjesin e 12 Gushtie 1998, në kazermën e shtabit në Baran, ai kishte intervistuar një vajzë të cilën e kishte parë të vrarë në pyllin e Lugut të Isufit¹⁹, por nuk i kujtohej nëse ishte i pranishëm kur ishte duke intervistuar Sanije Balajn²⁰.

Në shqyrtimin gjyqësor të mëparshëm ai ka deklaruar se në Baran Metë Krasniqi doli jashtë dhe e luti atë të intervistoj Sanije Balajn, pasi ajo njihje atë dhe nuk ishte duke e respektuar atë fare²¹.

Lirimi i Sanije Balajt nga Cuf Krasniqi

Sipas versionit të dhënë nga Cuf Krasniqi, pas afër pesë minuta pasi kishte filluar intervista, ai e kuptoi se do të ishte e pamundur të kishte një grua të pranishme gjatë

¹⁵ Dëshmia me datën 10 Maj, faqe 7, 10 dhe 11; Deklarata e Cuf Krasniqit e dhënë para policisë me datën 16 Shtator; Deklarata e dhënë para Prokurorit me datën 14 Shkurt 2006, faqe 10.

¹⁶ Deklarata e Cuf Krasniqit, 14 Shkurt 2006, faqe 10.

¹⁷ Dëshmia para trupit gjykues me datën 10.5.2007, faqe 15.

¹⁸ Dëshmia para trupit gjykues me datën 10.5.2007, faqe 17.

¹⁹ Deklarata para trupit gjykues me datën 17.11.2009, faqe 12:

Idriz Gashi: Ne shkuam ke pylli, mirëpo Avniu mbet prapa.

Kryetari i Trupit Gjykues: Dhe ti e ke parë trupin?

Idriz Gashi: Po.

....

Kryetari i Trupit Gjykues: Ajo ishte e njëjta femër të cilën e ke intervistuar atë mëngjes në kazermën e fshatit Baran?

Idriz Gashi: Po.

²⁰ Dëshmia para trupit gjykues me datën 17.11.2009, faqe 16:

Hasan Shala: Kur Cuf Krasniqi e morri në pyetje Sanije Balajn në shkollën e kuqe, ishit i pranishëm në atë kohë?

Idriz Gashi: Nuk më kujtohet, aty kishte shumë njerëz. Avniu dhe Iber ishin aty, burrat nga policia ushtarake.

Hasan Shala: Ishit ju të pranishëm?

Idriz Gashi: Nuk më kujtohet. Cuf Krasniqin e kam takuar këtu në gjykatë për të parën herë.

²¹ Proceverbali i Shqyrtimit Gjyqësor të mëparshëm të datës 24.05.2007, faqe 13-14.

marrjes në pyetje dhe prandaj ai vendosi të ndërprej atë dhe i adresoi Sanije Balajt fjalët që vijojnë: "Ne nuk mund të drejtojmë këtë intervistë. Ty nuk të lejohet që të shkosh në Pejë, sepse ti tani je e dyshimtë. Ti duhet të kthehesh në fshatin tënd për të marr leje për të shkuar në Pejë nga shtabi i fshatit tënd. Pastaj nëse është nevoja ne do të vijmë në shtabin e fshatit tënd ose te familja jote për të biseduar me ta rreth teje"²².

Sipas [redacted], Sanije Balaj ishte liruar nga [redacted] dhe ishte lejuar që të shkron në shtëpi. [redacted] ka shoqëruar atë nga kazerma ushtarake deri te stacioni i policisë dhe ka thënë: "Ajo tani është e lirë të shkron dhe familja e saj është duke ardhë për ta marr". Prej atij momenti askush nuk ishte i interesuar të ketë punë me të dhe ajo ishte lënë të presë kushërinjtë e saj [redacted] dhe [redacted].²³

Marrja në pyetje e Sanije Balajt nga i Pandehuri

Sipas [redacted], Sanije Balaj ishte në një zyrë në stacion të policisë dhe ishte duke pritur për kushërinjtë e saj për ta marr kur i pandehuri Galani doli nga makina afër kioskut dhe erdhi në stacion të policisë. [redacted] nuk e ka ditë nëse ai kishte ardhë me qëllim apo aksidentalisht dhe ka hasë në këtë person, mirëpo [redacted] hyri brenda dhe e morri në pyetje Sanije Balajn. Pastaj ai doli me një bllok shënimesh në duart e tij²⁴.

Në ekzaminimin e tij me 12 Nëntor 2009 ai e ndryshoi disi versionin e tij duke konfirmuar se "unë pashë (Idriz Gashin) duke ecur pranë nesh, në mes meje dhe shkollës, ku ishim të ulur. Unë nuk e pashë atë të hyjë. Nga pozita ku ishim ulur, ne nuk kemi mundur ta shohim duke hyrë, por e kemi parë atë brenda nga dritaret. Unë nuk e di se çka ka folë ai me të brenda në dhomë. Pas pak ai doli jashtë me Sanije Balajn dhe një bllok shënimesh të vogël në dorën e tij. Ai na u drejtue, oficer të policisë ushtarake, ai na ofendoi, "E shihni se gfarë personi keni brenda dhe nuk mërzhiteni!". Ai pastaj hapi bllokun e shënimeve dhe përmendi disa emra dhe numra të telefonit të disa kriminelëve, oficerëve policor të serbisë, por pasi ne ishim afër 10 metra nga ai, ne nuk mund ti shihnim emrat në bllokun e shënimeve. Ne e pamë se ai ishte shumë nervoz dhe i shqetësuar. Ai mu drejtua mua dhe më kërkoi të vozis Sanije Balajn dhe ta dërgoj atë në Shtabin e Gllogjanit. Idriz Gashi i ulur këtu mund të kujtohet mirë. Unë nuk e kam dituer se ai ishte një djalë aq i rreptë, kur e ka kryer këtë krim dhe provon që të përfshijë të tjerët"²⁵.

Sipas të pandehurit ai ishte lutë nga [redacted] që të intervistoj Sanije Balajn. Para fillimit të intervistës, Idrizi kërkoi nga ajo që të zbrazë çantën e saj dhe hetoi kozmetikën e saj, ca para dhe një bllok shënimesh të vogël. Kur ai e hapi bllokun e shënimeve ai lexoi një emër Serb në të, [redacted] e pyeti se kush ishte dhe Sanija u përgjegi një shok, derisa [redacted] dhe Iber Krasniqi dhe disa persona tjerë në korridor thanë se Zorani ishte Komandant i Stacionit të Policisë në Deçan. I pandehuri specifikoi se ai kishte për qëllim të detyroj Sanije Balajn që të bjerë [redacted] në një

²² Dëshmia para trupit gjykues me datën 10.5.2007, faqe 7, deklarata e 14 Shkurtit 2006, faqe 8.

²³ Proceverbali i shqyrtimit gjyqësor të mëparshëm të datës 16.05.2007.

²⁴ Dëshmia para trupit gjykues, 16.5.2007, faqe 9.

²⁵ Dëshmia para trupit gjykues, 12 Nëntor 2009, faqe 11.

zonë neutrale, dhe ta zëj atë të gjallë për ta përdorë atë si shkëmbim për Ukshin Hotin²⁶.

Largimi i Sanije Balajt nga Barani në Golfën e kuq.

... në dëshminë e tij të dhënë me 10 Maj 2007, ka deklaruar se e ka lutur dhe ... që të vozis Sanije Balajn në shtëpi dhe të dytë u përgjegjën se do ta dërgojnë atë. Ai pastaj u largua që të shkon në zyrën e tij dhe dy minuta më vonë e ka parë Sanije Balajn duke hyrë në një makinë Golf të kuq që ishte parkuar para hyrjes kryesore të shkollës. Aq sa i kujtohet, ai e ka parë të jetë ulur në ulësen e shoferit. Ai poashtu ka parë një ushtarë tjetër duke hyrë në pjesën e pasme, por nuk e ka njohur ushtarin. Kjo ishte hera e fundit që kishte parë Sanije Balajn²⁷.

Sipas deklaratës së ..., dhënë Prokurorit më 14.02.2006, kur ai vendosi të lirojë Sanije Balajn, e pyeti nëse dëshironte të drekonte me atë. Pasi ajo refuzoi, ai kërkoi nga policia ushtarake nëse kishin një makinë në dispozicion që ta dërgojnë në shtëpi. Pas përgjigjes pozitive të policisë ushtarake, ai e pyeti edhe një herë nëse ajo dëshironte të shkonte me atë ose me ata (... dhe ...) kurse ajo përsëri u përgjigj që do të shkonte me ata të dy. ... pastaj u largua nga dhoma, doli nga ndërtesa e shkollës dhe u nis në drejtim të një ndërtese tjetër. Ai kishte ecur këmbë 50 metra kur dëgjoi motorin e makinës, këthej kokën dhe pa Sanije Balajn duke hyrë në ulësen e mbrapme të makinës Golf me ngjyrë të kuqe. Meqë makina shfrytëzohej kryesisht nga ana e ... dhe ... dhe ai e kishte lënë atë me ata, mendoj se Sanija ishte në makinë me ... dhe me Gjatë intervistës ... theksoi në mënyrë specifike se e kishte parë vetëm Sanijen duke hyrë në pjesën e mbrapme të makinës, si dhe një person tjetër duke hyrë në makinë në ulësen e shoferit.²⁸

I pandehuri Idriz Gashi pohoi në të gjitha deklaratat e tija (madje edhe në atë të fundit që e dha më 17.11.2009) se Sanije Balaj u nis nga Barani me një Golf të kuq sëbashku me atë, të ulur në ulësen e bashkudhëtarit si dhe dhe me ... që ngiste makinën. Dëshironin të arrijnë në Gillogjan, por u ndalën në Pozhare për shkak të granatimit të ashpër.

Sipas të pandehurit, ai dëshironte të shkonte në Gillogjan për të biseduar me dikë atje me qëllim që të bindë Sanijen të sjellë Zoranin në fshatin Rosuje, meqë konsiderohej zonë neutrale, ta kapin të gjallë dhe ta përdorin në shkëmbim për Ukshin Hotin. Ai theksoi se kjo ishte strategji e adptuar nga vet ai dhe shokët e tij.²⁹

Sipas Avni Krasniqit, kur i pandehuri doli nga dhoma, ku Sanije Balaj intervistohet, e mbante një fletore të vogël dhe i tha atyre "a nuk e shihni se çfarë personi e keni brenda dhe nuk po ua ndien" dhe urdhëroi që ta dërgojnë me makinë atë dhe Sanijen në Gillogjan.³⁰

²⁶ Proceverbali i Shqyrtimit Gjyqësor të mëparshëm të datës 25 Maj, faqe 14; Deklarata para Prokurorit me datën 13 Tetor 2006.

²⁷ Dëshmia para trupit gjykues me datën 10.5.2007, faqe 8 dhe 14.

²⁸ Deklaratë e dhënë përballë Prokurorit më datën 14.02.2006, faqe 8, 9 dhe 12

²⁹ Procesverbal nga Gjykimi I mëparshëm Kryesor të datës 24 Maj 2007, faqe 14

³⁰ Deklaratë përballë Trupit Gjykues të datës 12 Nëntor 2009, faqe 11.

shtoi se në Golfin e kuq i opandehuri ishte i armatosur me AK-47 dhe një revole të modelit TT, kurse vet ai ishte i pa-armatosur, meqë atë ditë e kishte të lire dhe nuk ishte në detyrë.³¹ Në deklaratën e dhënë përballë Trupit Gjykses më 16 Maj 2007 ai tha se e kishte lënë armën e vete në makinën e tij personale.³²

Arritja në pyllin e Lugut të Isufit.

Sipas dëshmitarit _____, më 12 Gusht 1998, ai përkujdesej për lopët në Lugun e Isufit. E pa një makinë duke u ndalur, si dhe dy burra dhe një grua dilnin nga makina. Dy burrat dolën nga pjesa e parme e makinës kurse gruaja nga pjesa e prapme e makinës.³³

Dëshmitari e pa se gruaja nxirrej nga makina me forcë. Njeriu me uniformë hapi derën dhe e nxorri vajzën jashtë në mënyrë agresive. Pastaj pa që të tre duke hyrë në pyll, një burrë i armatosur dhe i veshur me uniformë u printe, kurse vajza gjendej në mes të dy burrave të tjerë. Dy tre minuta më vonë, doli jashtë (nga pylli) dhe urrdhëroi me zë dhe dy çunat e tjerë që ishin me atë që të shkojnë në shtëpi dhe ata vepruan sipas urrdhërit. Pas gjysëm ore duke ecur këmbë, para se të arrijë në shtëpi, dëgjoi dy të shtëna që vini nga Lugu i Isufit. Kur shkoi në shtëpi, së pari i tregoi nënës e pastaj edhe babait në lidhje me çfarë kishte ndodhur.³⁴

Dëshmitari _____ shpjegoi se, atë ditë, ai ngiste makinën në drejtim të Gllogjanit sëbashku me të pandehurin dhe Sanije Balajn. Kur kaluan fshatin Vranoc, i pandehuri i tha të merr një këthesë dhe pas 200 metrash i tha ndalej. Pastaj _____ deklaroi, siç vijon: *“Më duket se dëgjova Sanije Balaj që kërkoi nga Idriz Gashi nëse mund të flisnin privatisht. Nuk jam i sigurtë, më duket se Idriz Gashi nuk tha gjë. Ai e nxorri nga makina dhe shkuan në drejtim të pyllit. Pasi që dolën nga makina dhe shkuan në vendin e ngjarjes, diku pas 40 sekondash u dëgjuan dy të shtëna. I dëgjova të shtënat. E hapa makinën. Doja të dilja nga makina, por nuk ia arrita me dalë përveç se me një këmbë. Idriz Gashi u këthye me armë në dorë. Ai tha “Nëse dikush dëgjon për këtë, edhe ti do ta pësosh fatin e njejtë”. Ai e kishte një gëzhgjë në grykë dhe e vuri revolën në ryp... shkoi tek makina dhe më tha “nëse dikush mëson se çfarë ka ndodhur këtu, do ta pësosh njësoj”. Ikëm me makinë heshtaz në drejtim të fshatit Baran, E lash makinën tek Shtabi, e morra makinën time dhe u këtheva. Ndejta në shtëpi atë ditë. Isha shumë i zemruar në lidhje me atë çfarë kishte ndodhur”*³⁵

shtoi se ai poashtu pa disa barrija të rinj në një distancë prej 50 – 60 metrash gjër sa ishte në makinë.

Sipas të pandehurit Idriz Gashi, atë ditë ai u largua nga Shtabi në Baran me Sanije Balajn dhe _____ me Golf të kuq dhe shkuan në drejtim të Gllogjanit. Gajtë rrugës ata u ndalën në Pozhare, për shkak të granatimit të rëndë. Në Pozhare ia dorëzoi Sanije Balajn _____ sëbashku me fletoren e saj të vogël. Pastaj bëri

³¹ Deklaratë përballë Trupit Gjykses të datës 12.11.2009

³² Deklaratë e dhënë përballë Trupit Gjykses të datës 16.05.2007, faqe 13 dhe 28.

³³ Deklaratë e dhënë përballë Trupit Gjykses të datës 17.05.2007, faqe 35 dhe 36 si dhe deklaratë e dhënë përballë Trupit Gjykses të datës 10.11.2009.

³⁴ Deklaratë e dhënë përpara Trupit Gjykses më datën 10.11.2009, faqe 7 - 8

³⁵ Deaklaratë e dhënë përballë Trupit Gjykses më datën 12.11.2009, faqe 14 dhe 16.

përpjekje të shkojë në Glogjan këmbë dhe gati një orë më vonë u këthye në Pozhare, meqë ishte e pamundur të arrihej në Glogjan për shkak të granatimit të rëndë. Kur u këthyen në Pozhare, e takoi vetëm kurse dhe Sanija nuk gjendeshin aty më.

Pastaj i pandehuri dhe u iraguan nga Barani me një fugon të barrdhë (Golfi i kuq nuk gjendej më në Pozhare). Gjatë rrugës nga Pozhare për në Baran ata hasën disa barriq të rinj në vendin e quajtur Lugu i Isufit, të cilët thanë se diçka kishte ndodhur në pyll dhe se dy burra dhe një femër kishin arrdhur dhe barriqtë degjuan ca të shtëna. Pastaj Idrizi dhe kishin shkuar të shohin se çfarë kishte ndodhur. Ai hyri në pyll dhe pa trupin e Sanije Balajt, vazhën që e kishte intervistuar atë mëngjes. Pastaj u nisën për në Vranoc, nuk shkuan në Baran fare. Përgjatë rrugës Idrizi i tha se sigurisht ajo nuk ishte vrarë nga ana e paramilitarëve serb, por nga ushtarët e UÇK-së.³⁶

Fjalosja në mes të pandehurit dhe

Sipas i pandehuri ishte fjalosur dy here me të vëllain e vet, në lidhje me vrasjen e Sanije Balajt. Për herë të parë kjo ndodhi në Shtabin e Baranit, posa mësoi për këtë ngjarje meqë nuk kishte qenë present aty. Fjalosja e dytë ka ndodhë në shtëpinë e vete në Vranoc. Gjatë Gjykimit të Parë kryesor, dëshmitari tha se kishte qenë present kur dhe i pandehuri ishin fjalosur. Me 12.11.2009, përballë Trupit Gjykues, ai deklaroi se nuk ishte i sigurtë nëse ai ishte në të njejtën dhomë me ata ose në një dhomë tjetër të shtëpisë, por pasi që iu përkujtua dëshmia e tij më e hershme, ai e konfirmoi prezencën e tij gjatë kohës së fjalosjes.

"Kryetari I Trupit gjykues: Ju deklaruat në Gjyq në lidhje me fjalosjen në Vranoc, "Pasi që ata, bëhët fjalë për Galanin dhe Idrizin, shkëmbyen ofenduan njëri tjetrin, Galani tha "E kam vra vet, me dorë. Juve s'keni asgjë të bëni me këtë punë." Pastaj pyeti "Ku dhe pse e vrave?" kurse Galani u përgjigj: "Ky është problemi im. Nëse dikush e kërkon, I thuani se une e vrava, keni leje të tregoni". Dhe juve shtuat se ata ishin katër veta, Galani, dhe juve vet. Kështu deklaruat.

"E vërtetë është. Më kujtohet tash që më përkujtuat. Më përkujtuat fjalët e sakta që I ikishte thënë ai atje"

Kryetari I trupitgjykues: "Kjo ka ndodhë në Vranoc, tek vendi juaj?"

"jashtë Shtabit, jashtë shtëpisë sime."³⁷

I pandehuri Idriz Gashi konfirmoi përballë Trupit Gjykues se e kishte pasë një bisedë me në Vranoc, në shtëpi të afër lumit Bistrica, në lidhje me Sanije Balajn dhe pas këtij diskutimi ai u largua në drejtim të Lugut të Isufit me për të varrosur trupin e Sanijes me qëllim që ta mbrojnë nga shtazët e egra. Qëllimi i tij ishte që të varrosë trupin përkohësisht, të njohtojë familjen e saj në lidhje me vrasjen dhe për ta varrosur atë sipas traditës.³⁸

³⁶ Deklaratë e dhënë përballë Trupit Gjykues më datën 17.11.2009, faqe 10 – 14.

³⁷ Deklaratë e dhënë përballë Trupit Gjykues më datën 12.11.2009, faqe 20

³⁸ Dëshmi e dhënë përballë Trupit Gjykues më datën 17.11.2009, faqe 14

Varrosja e përkohshme e Sanije Balaj

... deklaroi se më 12 Gusht 1998, vonë pasdite, ai dhe ... shkuan në shtëpi pas largimit nga Shtabi në Baran. Atje u takuan me ... i cili i tregoi ... se kishte dëgjuar nga i biri i vet se dikush ishte vra tëk Lugu i Isufit. Prandaj, ata u grumbulluan me ... dhe të birin e tij ... dhe shkuan tek Lugu i Isufit³⁹.

Kur arritën tëk Lugu i Isufit, u ndanë në dy grupe: ai dhe ... në një anë, kurse ... dhe të tjerët në anën tjetër. ... dhe ... shkonin në drejtim të burimit dhe pak përpara se të arrijnë aty, ata dëgjuan një thirrje "Ndal", që pasoi me zhurmë të armës. Ai qendronte përpara ... dhe dëgjoi ... gjer sa i fliste personit me nofkën "Galani". Ai e njohti Galanin sepse e kishte parë po atë ditë në mëngjes tek Shtabi në Baran. Dëshmitari theksoi se nuk ishte hera e parë që e pa atë person: herën e parë e kishte parë një ditë më parë në Vranoc, ku mësoi se nofka e tij ishte Galani⁴⁰, kurse herën e dytë e kishte parë mu atë mëngjes duke dalë nga objekti shkollor në Baran, në mesin e një grupi njerëzish, pranë Sanijes dhe herën e tretë e kishte parë tek Lugu i Isufit⁴¹. Kur u afrua, e pa ... duke biseduar me Galanin dhe dëgjoi Galanin duke thënë "E vrava sepse e gjeta një fletore që përmbante emra serbe në të"⁴²

Sipas dëshmitarit ... Galani e kishte urrdhëruar atë dhe ... të qëndrojnë aty, kurse të tjerët u urrdhëruan të largoheshin nga vendi. Atë çast

³⁹ Deklaratë e dhënë përballë Trupit Gjykses, më datën 30.10.2009, faqe 7

⁴⁰ Deklaratë e dhënë përballë Trupit Gjykses më datën 30.10.2009, faqe 8:

Kryetari i trupit Gjykses: Si e dije se ky person ishte Galani?

Ahmet Ukaj: Kur shkova me djalin e Zumber Hasanajt tek vendi ku gjendej Zumber Hasanaj, mësova se ai ishte Galani

Kryetari i Trupit Gjykses: Por, si e mësove ti këtë?

Ahmet Ukaj: E kisha parë më përpara.

Kryetari i Trupit Gjykses: Po, por si e dije për nofkën e tij?

Ahmet Ukaj: E kisha dëgjuar tek Shtabi në Vranoc

⁴¹ Dëshmi e dhënë përballë trupit gjykses më datën 30.10.2009, faqe 13 – 14:

Kryetari i Trupit Gjykses: Tash kemi një pjesë tjetër të deklaratës; pyetja në deklaratë qëndronte kështu: "kur e ke parë Sanije Balajn për herë të parë dhe si e njeh atë?". Juve deklaruat se nuk e njihnit por e kishit parë për herë të parë tek shkolla fillore duke dalë jashtë me Galanin. Juve na deklaruat se e kishit parë Galanin dy ose tri ditë përpara ngjarjes tek Shtabi në Vranoc.

Ahmet Ukaj: Unë poashtu kam thënë se e kishë parë Galanin një herë në Vranoc një ditë më parë dhe kurrë më.

Kryetari i Trupit Gjykses: Juve e patë Galanin për herë të parë në Vranoc dhe herën e dytë në fshatin Baran duke dalë jashtë nga objekti i shkollës me një grup njerëzish sëbashku me Sanije Balajn?

Ahmet Ukaj: Nuk mund të them se ai e shoqëronte.

Kryetari i Trupit Gjykses: Juve e patë atë herën e dytë duke dalë jashtë ndërtesës së shkollës dhe afër e kishte Sanije Balajn.

Ahmet Ukaj: Po.

Kryetari i Trupit Gjykses: Dhe herën e tretë juve e patë këtë Galanin tek Lugu i Isufit kur u kërkua ndihma jote për të ndihmuar Avni Krasniqin të varrose kufomën?

Ahmet Ukaj: E konsiderova këtë të ishte hera e dytë meqë e pashë dy herë bredna një dite.

Kryetari i Trupit Gjykses: Juve e kishit parë po atë galan dy here Brenda një dite?

Ahmet Ukaj: Po e konsiderova vetëm si një herë.

Kryetari i Trupit Gjykses: Pra, juve e patë mu këtë Galanin një here në Vranoc, një here në fshatin Baran dhe përfundimisht tek Lugu i Isufit?

Ahmet Ukaj: Po

⁴² Dëshmi e dhënë përballë Trupit Gjykses më datën 30.10.2009, faqe 8 – 9 dhe 13

dëshmitari vërejti [redacted] duke arrdhur nga pylli dhe duke i thënë Galanit, si në vijim: "Gropa është gati, por nuk mund ta vendosë kufomën në gropë vetëm". Pastaj Galani i tha dëshmitarit të ndohmojë [redacted] për të varrosur kufomën. Ai e njohti kufomën, ishte ajo vajzë që e kishte parë më herët atë ditë tek Shtabi në Baran. Pasi ndihmoi [redacted], u këthye tek vendi ku Galani dhe [redacted] qendronin dhe e la Avniun për të mbulur kufomën. Pas dhjetë minutash, [redacted] iu bashkangjit atyre, kurse Galani i tha dëshmitarit dhe [redacted] të largohen dhe ata shkuan në një drejtim kurse Galani dhe [redacted] në drejtim tjetër.⁴³

Sipas [redacted], ai dhe Galani shkuan tek vendi i krimit me qëllim që të varrosin kufomën e Sanije Balajt. Ata shkuan atje bashk me [redacted] i cili e ngiste makinën. Kur arritën atje, qëndruan në vendin e ngajtjes, kurse [redacted] vazhoi me makinë. Galani fillimisht shkoi tek vendi ku shtrihej kufoma e Sanije Balajt dhe e urrdhëroi atë të hapë një gropë me qëllim që të vendosin kufomën në të, kurse Galani bënte roje.⁴⁴

Përafërsisht dhjetë minuta më vonë, [redacted] Jëgjoj Galanin duke thirrë "Mos lëviz se përndryshe të qëllojë" dhe dëgjoi Galanin duke e urrdhëruar [redacted] të shkojë dhe të ndihmojë [redacted] për të varrosur kufomën. [redacted] errdhi dhe ndihmoi atë për të varrosur trupin. Pas pakës ata u ndanë dhe shkuan në shtëpi.⁴⁵

[redacted] shkoi në pyll tek Lugu i Isufit me [redacted] dhe [redacted], sepse djali i [redacted] i kishte thënë atyre se dikush ishte vrarë atje. Ora ishte diku në mes 16:00 dhe 17:00. Kur arritën tek vendi, një person, të cilin nuk e njohte atëhere, thirri "Ndal". Sipas tij [redacted] ishte i detyruar të shkojë në pyll me [redacted], kurse ai qëndroi me Galanin. [redacted] e konfirmoi se Galani kishte thënë nëse dikush e kërkonte atë, ai e kishte vrarë vajzën, duke shtuar se ajo i kishte disa numra telefoni që i takonin serbëve.⁴⁶ Ai e njohti Galanin, meqë ishte hera e dytë e që e takonte (herën e parë në Baran).⁴⁷

Dëshmitari [redacted] ishte bashk me djalin e vet [redacted] dhe një person që quhej [redacted] dhe shkonin në drejtim të një vendi ku djali i tij i kishte dëgjuar disa të shtëna. Kur arritën tek vendi, ai dëgjoi një zë duke thirrë "Ndal" dhe pastaj po ai person i tha të marr me vete fëmijët dhe të largohet. Ai dëgjoi [redacted] ose [redacted] duke e thirrë një emër "Galan". Ata pastaj u larguan, duke e lënë [redacted] dhe [redacted] mbrapa. [redacted] dhe [redacted] u këthyen në fshat diku rreth gjysëm ore më vonë.⁴⁸

Zhvarrosja e kufomës së Sanije Balaj

Sipas [redacted], dy ose tri ditë pas vrasjes, ai gjendej në Shtabin e Baranit me ushtarët e tjerë kur Idrzi Gashi errdh me një gjip të zi bashku me [redacted], i njohur me nofkën "Togeri", dhe me dy ushtarë. Idriz Gashi i tha që ta shoqërojë Togerin dhe ushtarët e tjerë e t'ua tregojë vendin ku ishte varosur Sanije Balaj, me

⁴³ Dëshmi e dhënë përballë Trupit Gjykues më datën 30.10.2009, faqe 7 – 11.

⁴⁴ Dëshmi e dhënë përballë Trupit Gjykues, më datën. 12.11.2009., faqe 21

⁴⁵ Dëshmi e dhënë përballë Trupit Gjykues, më datën. 12.11.2009, faqe 21 - 22

⁴⁶ Dëshmi e dhënë përballë Trupit Gjykues, më datën. 17.05.2009, faqe 21

⁴⁷ Dëshmi e dhënë përballë Trupit Gjykues, më datën. 17.05.2009. faqe 25

⁴⁸ Dëshmi e dhënë përballë Trupit Gjykues, më datën. 10.11.2009, faqe 14 - 15

qëllim që të zhvarrosej kufoma. Meqë frikesohëj, e morri me vete për shkaqe sigurije.⁴⁹

Kur arritën tek varri, ai ishte me Togerin, dhe dy ushtarë të tjerë që nuk i njihnte. Me vete e kishin një lopatë dhe një batanije. Togeri i tha të fillojë të hapte gropën kurse dy ushtarë të tjerë e ndihmonin. E zhvarrosen kufomën, e mbështjellën me batanije dhe e futën në bagazhin e gjipit. Pastaj e përcollën atë dhe deri te Bistrica dhe u larguan.⁵⁰

I pandehuri e konfirmoi se një zhvarrosja ndodhi rreth tri dite pas vrasjes. Atë ditë ai shkoi në Baran me Idriz Balajn – “Togeri”, por nuk shkoi me ata për të zhvarrosur kufomën.⁵¹

Identifikimi i Sanije Balajt

për herë të fundit e pa Sanije Balajn më 12 Gusht 1998 rreth 08:30 në mëngjes në shtëpi të tij në Strelc, ku ajo jetonte me atë. Atë ditë Sanije Balaj e kishte të veshur një fustan me ngjyrë të ndryshme, të bardhë dhe të gjelbërt me pulla, papuqe njënjë portokalli dhe dy unaza.⁵²

deklaroi se ditën e vrasjes Sanije Balaj e kishte të veshur një fustan të bardhë me pika të zeza dhe mbante një çantë të dorës. Edhe pse errësohej kur shkoi në pyll me të pandehurin për të varrosur kufomën, ishte në gjendje të njeh trupin e Sanije Balajt.⁵³

Sipas Sanije Balaj kishte të veshur një fustan ngjyrë hiri dhe e mbante një çantë/kuletë me vete. Ai i deklaroi policisë se Sanije Balaj e kishte të veshur një “fun të bardhë si dhe një bluzë të bardhë”.⁵⁴

deklaroi se kur pa kufomën në pyllin e Lugut të Isufit, menjëherë e kuptoi se ishte mu ajo vajzë që e kishte parë në mëngjes. Ajo ishte e përgjakur në anën e majtë të gjoksit dhe e kishte të veshur një fustan me disa pika.⁵⁵

Identifikimi i eshtrave të Sanije Balajt

Eshtrat e Sanije Balajt janë gjetë dhe identifikuar më, 31 Maj 2007. Në dosjen e çështjes dokumenti i shënuar si Dokumenti A/Prova Materiale 41 që i referohet zbulimit të eshtrave të Sanije Balajt si dhe zhvarrosja e 38 trupave të tjerë në Shtator të viti 1999 në vendin afër kanalit të Glllogjanit që shpie për në Liqenin e Radoniqit.⁵⁶

⁴⁹ Dëshmi e dhënë përballë Trupit Gjykues, më datën. 12.11.2009, faqe 23

⁵⁰ Dëshmi e dhënë përballë Trupit Gjykues, më datën. 12.11.2009, faqe 24

⁵¹ Dëshmi e dhënë përballë Trupit Gjykues, më datën. 17.11.2009, faqe 14 - 15

⁵² Dëshmi e datës 9.5.2007, faqe 14 - 15

⁵³ Dëshmi e datës 16.05.2007, faqe 20, dëshmi e datës 12.11.2009, faqe 23

⁵⁴ Dëshmi e datës 09.05.2007, faqe 30, deklaratë e policisë e datës 21.10.2002

⁵⁵ Dëshmi e datës 17.05.2007, faqe 7

⁵⁶ Shkresat e Lendes së Gjykates, dosja nr.7

Materialet në Provën Materiale 41 poashtu përmbledhin shënime nga ana e ekspertëve serb të mjekësisë ligjore të monitoruar nga ana e OSBE-së si dhe përfaqësuesit e Britanisë së Madhe dhe të SHBA-vë. Fillimisht, 12 nga 39 trupa u identifikuan. Trupat e mbetur pastaj u varrosën në Gjakovë në varrezat Orthodoxe në Piskotë. Gjatë disa viteve që vijuan, eshtrat e paidentifikuara u insepktuan, iu nënshtruan autopsisë dhe u bënë përpjekje të identifikohen trupat e përmendur. Dokumenti A/Prova Materiale 41 përcakton kronologjinë e urdhërësive të Gjykatës dhe një sërë hapa të hetimeve të ndërmara; në mesin e këtyre janë tri raporte të ADN-së të datës 28 Maj 2007 të cilat tregojnë se njëra nga eshtrat e zbuluara në kanal në Shtator të viti 1998 e që më vonë janë transferuar në varrezat e Piskotës janë eshtrat e Sanije Balajt. Prokuroria poashtu prezatoi një kopje të një raporti (Dokument B/Prova materiale 41) në lidhje me autopsinë e kryer mbi eshtrat e Sanije Balajt.⁵⁷

Zotëri Krassimir Nikolov, ekspert nga Zyra e Personave të Zhdukur dhe Mjekësisë Ligjore (ZPZhML - OMPF), dëshmoi gjatë procesit të parë kryesorë gjyqësor në lidhje me përmbajtjen e Dokumentave A dhe B/Provave Materiale 41.⁵⁸

Ai deklaroi se më 2001 Kryqi i Kuq Ndërkombëtar informoi Njësinë e Personave të Zhdukur rreth ekzistimit të 25 varreve prapa kishës së Varrezave të Piskotës. Informata, të cilën Kryqi i Kuq Ndërkombëtar e pranoi ishte se eshtrat mortore të varrosura në varrezat e Piskotës mund të jenë të trupave të zbuluar në kanal in e Ratishës. Fal bashkëpunimit me autoritetet serbe, ishte e mundur të bëhet identifikimi me metoda tradicionale të eshtrave të 12 personave, të cilat iu këthyen familjarëve. Eshtrat mortore të të tjerëve, të cilët nuk u identifikuan atë kohë, pas autopsisë u varrosën në Varrezat e Piskotës. Varret u shënuan me pllaka druri me gërmat R. E dhe D. Pas hetimeve të mirëfillta dhe pas Urdhërit Gjyqësor, Njësia e Personave të Zhdukur zhvarosi trupat e varrosur në varrezat e Piskotës. Me atë rast, një mostër e eshtrave nga secili trup u dërgua në Komisionin Ndërkombëtar për Personat e Zhdukur për analizë të ADN-së. Pas kësaj zhvarrosjeje të gjitha eshtrat u vendosën në arkivole dhe lokacioni i varrosjes mbeti në atë gjendje sikurse edhe më përpara zhvarrosjes. Në vitin 2003, Njësia për Personat e Zhdukur, në bashkëpunim të ngushtë me ZPZhML e bëri zhvarrosjen e dytë të varrezave të Piskotës. Të gjitha eshtrat mortore u dërguan në morg për autopsy dhe ZPZhML ishte e obliguar që t'i ruajë eshtrat mortore në lokalet e ZPZhML-së deri sa të identifikohen.

Eksperti dëshmitar poshtu dëshmoi në lidhje me besueshmërinë e testeve të ADN-së: *Ekziston marrëveshja me Komisionin Ndërkombëtar për Personat e Zhdukur, i cili e kryen testing e ADN-së të eshtrave, në veçanti të mostrave të eshtrave dhe i krahason ato me të afërmit e personave të zhdukur, të grubulluara në rajon. Në bazë të analizave të ADN-së nga të afërmit si dhe të mostrave të eshtrave me profilet e ADN-së të familjarëve të personave të zhdukur nga njëra anë dhe mostrat e ADN-së të nxjerra nga eshtrat mortore në anën tjetër, është e mundur të bëhet krahasim i profileve të ADN-së, në bazë të të cilave mund të identifikohen eshtrat mortore. Në përputhje me deklaratën e Komisionit Ndërkombëtar për Personat e Zhdukur identifikimi i saktë është mbi 99.9 përqind me anë të kësaj metode, e cila nuk lë vend për dyshim se kemi identifikim të eshtrave mortore 99.9 përqind të sigurtë nëse kemi identifikim pozitiv.*⁵⁹

⁵⁷ Shkresat e Lendes së Gjykatës, dosja nr.7

⁵⁸ Dëshmi e datës 14.06.2007

⁵⁹ Dëshmi e datës 14.06.2007, faqe 6

Hetimet e UÇK-së në lidhje me zhdukjen e Sanije Balajt

... dhe ... deklaruan se, disa ditë pas zhdukjes së Sanijes, i kanë dhënë deklaratë ... dhe ..., oficerëve të UÇK-së. Sipas ..., hetuesit e UÇK-së ishin në gjendje të kompletojnë hetimet e tyre⁶⁰. ... deklaroi se ..., i cili ishte Komandant Brigade, errdhi në Baran dhe i tha ... se duhej të shkonte në Prapaqan me qëllim që të zbarrdhë rastin e Sanije Balajt. ... morri makinën dhe shkoi në Prapaqan. Atje takoi të ndjerin ... dhe ... Aty kishte edhe njerëz të tjerë, por ai nuk i njohte. Ai e njohte ..., i cili e zhvillonte intervistën. Kjo ndodhi dy javë pas vrasjes së Sanije Balajt.⁶¹

Poashtu ... dhe ... deklaruan se, katër ose pesë ditë pas vrasjes së Sanije Balajt, dhanë deklaratë në kazernat e Prapaqanit përpara ... dhe të tjerëve në Prapaqan.⁶²

Morris Irvin dëshmoi se gjatë procesit të hetimeve është përpjekur të gjejë procesverbalin e hetimeve të zhvilluara nga ana e UÇK-së në Prapaqan, në veçanti në lidhje me rastin e Sanije Balajt. Zyrtari mësoi se lokacioni i intervistave fillimisht gjendej në kazernat e UÇK-së në Prapaqan. Atje gjendej një ndërtesë e shkollës, shkoi në shkollë të fliste me zëvendës-drejtorin e shkollës, i cili e konfirmoi se objekti shkollor kishte shërbyer për hetime gjatë luftës. Zëvendës-drejtori shtoi se asnjë shënim ose procesverbal nuk është lënë aty dhe se kur u zhvillua ofensiva serbe, brendësia e shkollës u djeg plotësisht dhe arka që mbante dokumentat u zhduk.⁶³

2. c) Deklarata e të akuzuarit

Më 17.11.2009, i pandehuri, përballë Trupit Gjykses deklaroi se qëndron prapa deklaratave të mëparshme që i ka dhënë më 24.05.2007, 15.11.2006 dhe 13.10.2006. Sidoqoftë, më 17.11.2009, si dhe më 19.11.2009 u kërkua të japë sqarime të pjesës së tregimit në lidhje me largimin e tij nga Barani më 12 Gusht 1998 me Golf të kuq dhe pranoi të hetohet:

Kryetari i Trupit Gjykses: A qëndron prapa deklaratave tuaja të mëparshme, dhënë para Trupit Gjykses me datën 24-05-07, si dhe me datën 15-11-06 para Zotëri Dean, Prokurorit Publik?

Idriz Gashi: Po.

Kryetari i Trupit Gjykses: Dhe asaj para Gjyqtarit të Procedurës Paraprake me datë 13-10-06?

Idriz Gashi: Po.

Kryetari i Trupit Gjykses: Pasi që qëndroni prapa tyre, nëse të kam kuptuar si duhet, versioni juaj për ngjarjet është si ne vijim; Mendoj se është e pakontestueshme që me datën 12-08-98, ti u largove nga fshati Baran me Golf të kuq me ... dhe Sanije Balaj. A është kështu?

⁶⁰ Deklaratë e datës 09.05.2007, faqe 13 dhe 31

⁶¹ Dëshmi e datës 10.05.2007 dhe deklaratë e datës 14.02.2006, faqe 14

⁶² Deklaratë e datës 17.05.2007, faqe 8 dhe 23; deklaratë e Hysen Ukaj e datës 22.11.2006, faqe 6

⁶³ Dëshmi e datës 17.05.2007, faqe 42

Idriz Gashi: Po. Deri ne Pozhar.

Kryetari i Trupit Gjykues: me sa po kuptojëj, ishit nisur për ne Gllogjan, por u detyruat te ndaleni në Pozhare për shkak te granatimeve te ashpra.

Idriz Gashi: E vërtetë.

Kryetari i Trupit Gjykues: Ne Pozhare, ju takuat ... Ju i dorëzuat atij Sanije Balaj.

Idriz Gashi: Po.

Kryetari i Trupit Gjykues: Bashkë me fletoren.

Idriz Gashi: Po, ishte fletore e vogël.

Kryetari i Trupit Gjykues: Dhe pastaj u përpoqe qe te shkoje ne këmbë ne Gllogjan.

Idriz Gashi: Po.

Kryetari i Trupit Gjykues: Pas 40 minutave apo një ore ti u ktheve ne Pozhare, për shkak te bombardimeve.

Idriz Gashi: Mund te ketë qene me shume se 40 minuta, por është e vërtetë se unë u ktheva.

Kryetari i Trupit Gjykues: Ti the mes 40 minutave dhe një ore, a është kështu?

Idriz Gashi: Po, edhe pse mund te ketë qene me shume se një orë, ndoshta një orë e njëzetë apo një orë e dyzet minuta.

Kryetari i Trupit Gjykues: Kure ishe prape ne Pozhare, ti pe ... , por jo edhe Sanije Balaj, dhe po ashtu ju edhe Ti nuk pe Golfën e kuq?

Idriz Gashi: Po.

Kryetari i Trupit Gjykues: Nga Pozhare ju u munduat qe te shkonit prapa ne Gllogjan me ... , brenda një furgoni te bardhe. A është kështu?

Idriz Gashi: Jo, ne nuk u munduam qe te shkonim ne atë moment atje.

Kryetari i Trupit Gjykues: Ku donit te shkonit?

Idriz Gashi: U kthyem. Unë e pyeta atë, "Ku janë te tjerët?" Ai tha, "Ata u kthyen." Unë e pyeta atë, "Pse nuk shkove edhe ti me ta?" Ai u përgjigj, "Po te prisja ty se ti mund te ktheheshe para granatimit."

Kryetari i Trupit Gjykues: Ku shkuat?

Idriz Gashi: Shkuam ne fshatin Baran me një furgon te vogël te bardhe.

Kryetari i Trupit Gjykues: Gjate këtij udhëtimit nga Pozhara ne fshatin Baran, ju u ndeshet me një çoban te "Lugu i Isufit", a është kështu?

Idriz Gashi: Ishin fëmijë.

Kryetari i Trupit Gjykues: Ata ndaluan veturën dhe ju thane ju dyve, apo vetëm ty, nuk jam i sigurte, se diçka kishte ndodhur ne mal.

Idriz Gashi: Dy veta erdhën dhe ata thane nj efemer, jo grua apo vajzë. Pastaj ata thane se dëgjuan te shtëna, dhe u larguan.

Kryetari i Trupit Gjykues: Pastaj ju shkuat qe te kontrolloni ne mal se a kishte kufomë?

Idriz Gashi: Shkuam te shihnim se çka kishte ndodhur.

Kryetari i Trupit Gjykues: Me ... ?

Idriz Gashi: E pyeta ... se a kane mundur te hynin Paramilitaret ne lug nga ana tjetër sepse fëmijët na thane se kishin qen te veshur ne te zezë. Shpesh Paramilitaret visheshin asi soji.

Kryetari i Trupit Gjykues: A e pe kufomën me atë rast?

Idriz Gashi: Shkuam ne mal, por ... qëndroj prapa.

Kryetari i Trupit Gjykues: Dhe ti pe kufomën?

Idriz Gashi: Po.

Kryetari i Trupit Gjykues: ishte hera e pare qe shkove te "Lugu i Isufit", atë dite?

Idriz Gashi: Po.

Kryetari i Trupit Gjykses: Pastaj çka bëre? A u ktheve ne fshatin Baran?

Idriz Gashi: Shkuam ne fshatin Baran. I thashë ... se ajo ishte vrare nga Paramilitaret.

Kryetari i Trupit Gjykses: Mendon nga Serbet?

Idriz Gashi: Po.

Kryetari i Trupit Gjykses: Ishte e njëjta femër qe ti intervistove atë mëngjes ne barakat e fshatit Baran?

Idriz Gashi: Po.

Kryetari i Trupit Gjykses: Ne fshatin Baran ti pate një diskutim me ...

Idriz Gashi: ishte ne Vranoc.

Kryetari i Trupit Gjykses: Pastaj shkove ne fshatin Baran?

Idriz Gashi: Vranoci është para fshatit Baran. Atë dite nuk shkuam ne fshatin Baran fare.

Kryetari i Trupit Gjykses: Ti pate diskutimin ne Vranoc?

Idriz Gashi: Ne fillim ne e patëm diskutimin afër një lumi, lumit Bistrica, afër shtëpisë se tij.

Kryetari i Trupit Gjykses: Ju shkuat atje? (Shënim i gjyqtarit: mendon Vranoc)

Idriz Gashi: Jo, shkuam ne shtëpinë e ...

Kryetari i Trupit Gjykses: Ku është shtëpia e ...?

Idriz Gashi: Afër lumit Bistrica.

Kryetari i Trupit Gjykses: Pas diskutimit, a shkove te "Lugu i Isufit" me ... me Golf te kuq?

Idriz Gashi: Po.

Kryetari i Trupit Gjykses: Vetëm ti dhe ...? Apo ju dërgoj me veture atje ...?

Idriz Gashi: Jo, vetëm unë dhe ... voziti.

Kryetari i Trupit Gjykses: ADhe kjo ishte hera e dyte qe shkove te "Lugu i Isufit" atë dite?

Idriz Gashi: Po.

Kryetari i Trupit Gjykses: Kure u intervistove nga Prokurori Publik ti the se me atë rast pe dy polic ushtarak.

Idriz Gashi: Jo, ata erdhën me vone.

Kryetari i Trupit Gjykses: Atë here, kure shkove për te dytën here?

Idriz Gashi: pasi qe shkova te dytën here. Ne mbrëmje.

Kryetari i Trupit Gjykses: Kush ishin këta dy polic? A i njohe?

Idriz Gashi: I njoha nga pamja.

Kryetari i Trupit Gjykses: A ishin ata ... dhe ...?

Idriz Gashi: Po.

Kryetari i Trupit Gjykses: Dallimi ne mes versionit tende dhe atij te dhënë nga ... dhe ... është se qe te dy thane se ti u shprehe me këto fjale, "Unë e vrava vajzën." Kurse ti mohon te kesh thënë këto fjale. Por ti nuk e mohon se me ate rast tip e ... dhe ... A është kështu?

Idriz Gashi: Po, ata ishin mu aty. Me një grup njerëzish.

Kryetari i Trupit Gjykses: Ishe ti qe i the këtij grupi te njerëzve, "Stop"?

Idriz Gashi: Po. Unë i ndalova ata, por jo ne mënyrën qe ju e përshkruani. Është e vërtetë se ju thashë atyre qe te ndalonin, por jo ne mënyrë te ashpër.

Kryetari i Trupit Gjykses: Ne vend, përpos ... dhe ... dhe te tjerëve te cilët erdhën me ta, a ishe vetëm ti dhe Avniu?

Idriz Gashi: Po.

Kryetari i Trupit Gjykses: ... nuk ishte i pranishëm apo ...?

Idriz Gashi: Jo.

Kryetari i Trupit Gjykues: Ne këtë herën e dyte a ishte e mundur që te varrosej trupi a jo?

Idriz Gashi: Nuk e kuptoj pyetjen.

Kryetari i Trupit Gjykues: A ishte e mundur të mbulohej trupi me ca dhe? Mendoj, të vendosesh trupin në një far varri? A ishte e mundur?

Idriz Gashi: Ishte e qarte se pasi që ishte gjetur trupi se ata ishin munduar ta fshihnin trupin.

Kryetari i Trupit Gjykues: Ata? Mendon njerëzit të cilët e vranë këtë person?

Idriz Gashi: Po, Mendoj dhe.

Kryetari i Trupit Gjykues: Po. Sipas teje Sanije Balaj e vrau dhe?

Idriz Gashi: Unë nuk e pashe atë që e vrau atë.

Kryetari i Trupit Gjykues: A the "ate" apo "ata"?

Idriz Gashi: Une nuk i pashe ata që e bene. Une thashe "ata." Sidoqofte, ashpërsia e tyre në bisede si dhe armiqësia ishte me e madhja në mes dhe Sanije Balaj.

Kryetari i Trupit Gjykues: Ti, se bashku me , u munduat të varrosni trupin. A ishte e mundur të vihej trupi në varr a jo? Nuk po flas për varr të mermertë. Po flas për një gropë në toke.

Idriz Gashi: Ishte e mundur ta beje përkohësisht.

Kryetari i Trupit Gjykues: Ta vesh në grope?

Idriz Gashi: Vetëm ta mbulosh trupin sepse, për shkak të granatimit, qenet po i nxjerrin trupat. Ishin disa gropa aty. Qëllimi im ishte që ajo të varrosej përkohësisht, të informohej familja dhe pastaj të fillojë procedura.⁶⁴

Kryetari i Trupit Gjykues: Dëshirojë të kethehemi në momentin në të cilin ishte duke e varrosur kufomën e Sanije Balajt tek Lugu i Isufit dhe në pikën ku dhe arritën. Tani më ju është shtruar pyetja në lidhje me këtë dhe juve that se asnjëherë nuk keni thënë këto fjalë: "nëse dikush pyet ndonjëherem thuan se une e vrava, tash mund të shkoni, e vrava sepse e gjeta atë fletoren e vogël", a mohoni ende t'i keni thënë këto fjalë, kur themi këtë, këto fjalë domosdoshmërisht nuk do me thënë se keni vrarë femrën, a mohoni të keni thënë këto fjalë meqë dëshirojë t'ua bëjë me dije se nëse janë thënë këto fjalë nuk do me thënë se juve e keni vrarë këtë grua.

Idriz Gashi: Kjo është e vërtetë sepse po ti kasha thënë këto fjalë, Gjyqi duhet të konstatojë se I kam thënë këtë "UÇK-ja e vrau atë dhe është e vërtetë se është vrarë nga ana e oficerëve. A ka neri në këtë botë që do të kryente një krim."

Kryetari i Trupit Gjykues: Pra këto janë fjalët që juve shqiptuat me atë rast?

Idriz Gashi: Thash se UÇK-ja e vrau atë, nuk kasha hsënime me vete, ia kasha lënë këtë

Kryetari i Trupit Gjykues: Pra, juve e mohoni të keni thënë se e vratë atë?

Idriz gashi: Po

Kryetari i Trupit Gjykues: Mbase dëshironit të mbuloni dikë tjetër?

⁶⁴ Procesverbal I datës 17.11.2009, faqe 10 - 14

*Idriz gashi: Do të ishte e logjikshme, por nuk I shqiptova ato fjalë, ishte situatë e tensionuar dhe UÇK-ja e vrau atë, atë që ia thash , ua thash atyre. Kjo është e vërteta.*⁶⁵

3. Dëshmitë shtesë dhe procesverbal i siguruar gjatë seancave të gjykimit kryesor

Gjyqi kërkoi sipas detyrës zyrtare të dhëna të ndjekjes penale të të pandehurit nga Gjyqi i Qarkut të Pejës dhe nga Gjyqi Komunal i Pejës. Sipas shënimeve të dy Gjykatave, i pandehuri asnjëherë nuk është dënuar për ndonjë vepër penale përballë këto Gjyqeve.

Përveç kësaj, Trupi Gjykues sipas detyrës zyrtare siguroi Aktgjykimin e lëshuar nga Gjykata Ndërkombëtare për Krime në ish-Jugosllavi në rastin kundër Ramush Haradinaj dhe të tjerët më 3 Prill 2008, duke theksuar se Aktgjykimi i sipërm nuk ishte përfundimtar dhe se rëndësia e saj në rastin konkret kufizohet në rrethanat faktike të një Aktgjykim që trajtoi edhe rastin e Sanije Balaj të lëshuar nga ana e Gjyqit Ndërkombëtar për Krime në ish-Jugosllavi.

E. VLERESIMI I DESHMIVE TE PARAQITURA

1. Gjetjet faktike dhe ekzaminim i pjesëve të dëshmisë

Pas prezantimit të dëshmimeve dhe deklaratave si më sipër, sa i përket rikonstruktimit të ngjarjeve që ndodhën në ditën kritike më 12 Gusht 1998, mund të konsiderohen pa dyshim si të dëshmuara pikat në vijim, në bazë të autopsisë, dëshmitë e dëshmitarëve dhe pohimet e të pandehurit:

- Trupi i Sanije Balaj u gjet në një varr masiv afër Liqenit të Radoniqit në Shator të vitit 1998. Fal analizave të ADN-së, pa dyshim dhe pa diskutim kufoma në fjalë është e Sanijes së ndjerë; autopsia konstatoi se ajo ishte qëlluar me tri të shtëna me armë zjarri, një në kokë, një në gjoks dhe një në pjesën e barkut;
- Sanije Balaj, në mëngjesin e 12 Gushtit 1998, duke shkuar rrugës për në Pejë bashkë me kushëririn e saj , është ndalur në Baran nga ana e policisë ushtarake dhe është marr në pyetje nga ana e ; poashtu Idriz Gashi, i njohur si Galani, ka qenë prezent gjatë intervistës, edhpse ai nuk intervenoi (rrethanat se gjatë luftës Idriz Gashi ishte i njohur me nofkën Galani, është e pakontestueshme dhe këtë gjë e pohoi edhe vet i pandehuri);
- dhe e kanë parë Sanije Balajn në Baran duke dalë nga shkolla, ku ishte marr në pyetje, në mësin e grupit të njerëzve duke përfshi edhe Idriz Gashin;
- Sanije Balaj u largua nga Barani me Golf të kuq bashkë me dhe Idrzi Gashin; makina u nisë në drejtim të Gllogjanit (është me rëndësi se vet i pandehuri e pohoi këtë se pas marrjes në pyetje Sanijen në Baran, ai u largua për në Gllogjan bashku me atë dhe me me Golf të kuq);

⁶⁵ Porcesverbal i datës 19.11.2009, faqe 15

në këtë pikë duhet cekur se gjatë gjykimit të parë kryesor, deklaroi se dy persona që shkuan me makinë me Sanije ishin (procesverbal i datës 10 Maj 2007, faqe 8), kurse vet i pandehuri pohoi se ai dhe hynë në makinë me Sanijen. Kontradikta mund të zgjidhet lehtë duke marrë parasysh deklaratat e mëhershme të më 14 Shkurt 2006, gjatë marrjes në pyetje nga ana e Prokurorit, dëshmitari pohoi (faqe 12) se nuk ishte i sigurtë në lidhje me dy ushtarët që hynë në makinë dhe se njëri prej tyre mund të ketë qenë Galani. Në intervistën e dhënë policisë më 16.09.2005, deklaroi qartë se e pa duke hyrë në Golf në ulësen e shoferit si dhe vërejti një ushtar tjetër duke hyrë në makinë dhe mendonte se ky ushtari ishte , meqë dhe ishin gjithmonë bashk, por në të vërtetë ai nuk pa ushtarin tjetër. Për arsyet e lartpërmendura mund të konsiderohet si e pakontestueshme dhe pa fije dyshimi se dy njerëz të cilët hynë në Golf bashkë me Sanijen dhe u larguan nga Barani në drejtim të Gillogjanit ishin dhe Idrzi Gashi.

- Po atë ditë pa një makinë që ndalej tek Lugu i Isufit, dy burra dolën nga makina dhe shoqëronin një grua në drejtim të pyllit; dëshmitari shtoi se njëri nga dy burrat i urrdhëroi të largohet nga vendi. iu nënshtrua urrdhërit dhe u largua nga vendi; pas gjysëm ore dëgjoi 2 ose 3 të shtëna;
- Posa shkoi në shtëpi, i tregoi nënës e pastaj edhe babait () në lidhje me çfarë kishte ndodhë tek Lugu i Isufit dhe pas pakës, dhe shkuan në vendin e lartpërmendur të shikojnë; posa arritën atje, një person i veshur me uniformë, i urrdhëroi atyre të ndalen; këtë person dhe e njihnin si ushtar Galani, po atë person që e kishin parë në mëngjes në Baran, tek kazernat duke dalë nga shkolla bashkë me Sanijen; Galani i tha dhe të rrinin aty, kurse të tjerët urrdhëroi të largoheshin; në veçanti i urrdhëroi të shkojë në pyll të ndihmojë për të hapë varrin;
- Ahmeti iu nënshtrua urrdhërit, shkoi në pyll ku gjeti , i cili tashmë kishte filluar të hapte varrin; posa u hap varri, dy burrat e futën kufomën në të: të gjitha deklaratat (, dhe Idrzi Gashi) përputhen në një pikë se kufoma që varrosej i takonte gruas që u ndalua po atë ditë në Baran;
- dhe deshmuan se tek Lugu i Isufit, Galani kishte thënë se ai vet e kishte vrarë atë grua dhe se personi që shihnin aty ishte mu personi që e kishin parë në Baran, në mëngjes të asaj dite bashkë me Sanije Balajn;
- I pandehuri pohoi se ishte prezent me rastin e varrosjes se Sanijes tek Lugu i Isufit dhe se atje, përveç , ai pa edhe dhe

Të gjitha këto rrethana të pakontestueshme çojnë në përfundim se Idriz Gashi, poashtu i njohur si Galani, më 12 gusht 1998, tek Lugu i Isufit, pohoi në prezencë të se ai vet e kishte vrarë Sanije Balajn.

Në fakt, është e pamohueshme se më 12 Gusht 1998, dhe e kishin parë atë në Baran dhe pastaj tek Lugu i Isufit me ç'rast deklaroi se e kishte vrarë atë grua. Të dytë, dhe e njihnin Galanin prandaj është e pamundur se e

ngatërruan Galanin me ndonjë person tjetër (përveç kësaj, i pandehuri vet pohoi se e kishte parë [] dhe [] tek Lugu i Isufit me rastin e varrosjes).

Meqë Idriz Gashi pohoi se atë ditë në mëngjes ishte në Baran dhe pastaj tek Lugu i Isufit kur kufoma u varros, përfundim i vetëm logjik i mundshëm është se Idriz Gashi është personi i quajtur Galani, i cili e pranoi vrasjen e Sanije Balaj. Në lidhje me këtë pikë duhet shtuar se Idrizin e njohti si personin e quajtur Galan, i cili e kishte pranuar vrasjen e vajzës, edhe [] gjatë Gjykimit të Parë Kryesor: shih procesverbalin e datës 17 Maj 2007, faqe 26:

Idriz Gashi: A të ndala me një fjalë?

Hysen Ukaj: Po

Idriz Gashi: Çfarë dëgjove?

Hysen Ukaj: Une thash : "Jam unë"

Idriz Gashi: [] dëshmoi se ti qëndrove me mua gjithë kohën deri sa ata e varrosën kufomën. A është e vërtetë?

Hysen Hukaj: Po.

Idriz Gashi: A ta tregova fletoren?

Hysen Hukaj: Nuk më kujtohet.

Idriz Gashi: Ti dëshmove se une paskam thënë: "Nëse dikush e kërkon atë, tergo se unë e vrava"

Hysen Hukaj: Po, e konfirmojë këtë.

Është me rëndësi që aktgjykimi i Gjyqit Suprem nuk e ka marr parasysh këtë pjesë të kësaj deklarate të []: në fakt sipas aktgjykimit të lartpërmendur, [] thjesht deklaroi "se një njeri që pohonte se është Galani, tha "E kam vrarë" dhe se kjo deklaratë nuk mund të konsiderohet si dëshmi bidnëse duke e marr parasysh se identifikimi i të pandehurit si njeriu që foli në muzg është më së paku e dyshimtë".

Prandaj, në lidhje me pjesën e cekur të dëshmisë së [], vlerësimi i bërë nga ana e Gjyqit Suprem në lidhje me dëshminë e [] nuk mund të konsiderohet si detyruese dhe i lejon Trupit Gjykses mundësinë e vlerësimit të lirë të asaj pjese të deklaratës.

Përveç kësaj, me qëllim që të shpërfillëshin deklaratat e [] dhe [] si dhe e [], e vetmja mundësi do të ishte që të paramendohej se është janë një fabrikim gjigant kundër të pandehurit e organizuar nga ana e tre personave të lartpërmedur në lidhje me fjalët e shqiptuara nga ana e të pandehurit në Lugun e Isufit gjer sa e varrosnin trupin e të ndjerës Sanije: sidoqoftë, në lidhje me këtë pikë, asnjë provë nuk doli si e fabrikuar ose e falsifikuar.

Në të kundërtën, me dëshmitë e tyre [] dhe [] në dukje ishin mjaft të matur dhe gati ngurues që t'ia drejtojnë gishtin të pandehurit.

Për shembull, as në Gjykimin e Parë Kryesor e as në Gjykimin e Dytë Kryesor [] nuk tha se mund ta njohte Galanin, meqë e kishte parë vetëm për disa çaste dhe se kishte kaluar një kohë e gjatë që nga ajo ngjarje: (procesverbal i datës 17.05.2007, faqe 14; shih procesverbalin e datës 30.10.2009, faqe 13:

Prokurori Publik: Juve deklaruat se pas natës së varrosjes së vajzës së vdekur, asnjëhere nuk e keni parë atë përsëri; amendoni se mund ta identifikoni po ta shihni?

[]: Jo, ishte nje moment i shpejte gjate asaj dite dhe nuk eshte e mundur ta njoh ate tani).

Gjithashtu edhe deshmia e [redacted], ne ate pike nuk eshte e qarte sepse eshte theksuar nga Gjykate Supreme ne vendimin e marre me 2 Qeshor 2009: (procesverbali i dates 17.5.2007, faqja 25:

Idriz Gashi: A te kujtohem? [redacted]: Ju keni pasur mjekerr me pare por une nuk ju njoha.)

Pergjigje te tilla nuk duken te jene pergjigje tipike te dhena nga njerez te cilet mundohen ti manipulojne ngjarjet me qellim qe rrejshem ti akuzojne te tjeret. Ne kundërshtim, ekziston pershtypja se edhe [redacted] edhe [redacted] nuk kane dashur te akuzojne Idriz Gashin edhe pse nuk kane mundur te mohojne se ai ishte Galani dhe se Galani ishte personi i cili e ka pranuar vrasjen te Lugu i Isufit.

Pas vleresimit te deshmive te [redacted] dhe [redacted] si te sigurta dhe te besueshme ne piken e fjaleve te shprehura nga ana e Idrizit/Galanit te Lugu i Isufit, fjaltet e lartepemendura mund te definohen, thene teknikisht, si nje pranim jashtegjyqesor qe duhet te vleresohet dhe te shqyrtohet ne teresi ne menyre qe te vertetohet se a eshte i besueshem apo a mund te egzistojte mundësia e vete akuzimit te rrejshem.

Ne fakt, mund te mendohet si nje parim i pergjithshem se pranimi jashtegjyqesor, edhe pse nuk nuk perben vertetim te pathyeshem te pergjegjesise, mund te jete burim i lire i bindshmerise se Gjyqtarit nese eshte dhene elemente vertetuese dhe nese vertetohet origjinaliteti dhe spontaniteti i tij.

Ne ketë qeshtje se pari duhet te konsiderohet mundësia se, kur Galani e akuzon veten se e ka kryer vrasjen, ai e ka mbuluar dikën tjetër, ndoshta [redacted] apo te tjerët. Me fjale tjera duhet te vlerësohet se a e ka fajësuar i pandehuri veten ne mënyre te rrejshme ne ditën kritike te Lugu i Isufit.

Ky opcion duket si mezi i mundshëm meqe kjo rrethane është përjashtuar nga vete i pandehuri i cili jo vetëm qe e ka mohuar se i ka thënë fjaltet e lartpërmendura por ai gjithashtu përjashton rrethanën se ai ka pasur ndonjë qellim te mbuloj dikën tjetër ne lidhje me vrasjen e Sanije Balaj (procesverbali i datës 19 Nentor 2009, faqja 15:

Kryetari i Trupit Gjykues: Do te dëshiroja te kthehem tek momenti kur [redacted] ka qene duke e varrosur kufomen e Sanije Balaj te Lugu i Isufit dhe ne ate vend kane mbërritur [redacted] dhe [redacted]. Ju vetëm jeni marre ne pyetje për ketë dhe keni thënë se ju kurrë nuk i keni thënë këto fjale: " nëse dikush ndonjëherë ju pyet ju i thoni se unë e kam vrare ate. Tani mund te shkoni. Unë e kam vrare sepse e kam gjetur atë fletoren e vogël te shënimeve" A mohoni ende se ju i keni thënë këto fjale, sepse te folurit e këtyre fjaltëve nuk do te thotë detyrimisht se e keni vrare atë grua? A e mohoni se i keni thënë fjaltet e tilla sepse dua t'ju beje me dije se nëse i keni thënë ketë kjo nuk do te thotë se ti e ke vrare atë grua.

Idriz Gashi: Kjo është e vërtete sepse nëse e kisha thene ate, gjykata duhet te përcaktoje se unë kam thene UÇK e ka mbytur ate dhe është e vërtete se ajo është vrare nga oficeret. A ka ndonjë person ne ketë bote i cili do te kryente nje krim?

Kryetari i Trupit Gjykues: Atëherë këto janë fjaltet qe ju i keni shprehur ne atë rast?

Idriz Gashi: Thashe se UÇK e ka vrare atë. Une nuk kam pasur ndonjë shënim me mua qe e kam lëne me [redacted].

Kryetari i Trupit Gjykues: Atëherë ti e mohon se ke thënë qe ti e ke vrare atë?

Idriz Gashi: Po.

Kryetari i Trupit Gjykues: Ndoshta ke dashur ta mbulosh dikën tjetër?

Idriz Gashi: Do te ishte logjike por nuk i kam leshuar ato fjale. Ka qene situatë e tensionuar dhe UÇK e ka vrare atë. Ate qe i kam thënë ... i kam thënë edhe atyre. Kjo është e vërteta).

Perveq kësaj, gjate tere kohës se procedurës penale nuk ka dalur asnjë element logjik apo faktik qe do bënte njeriun te mendoje se Idriz Gashi ka pasur interes, nevojë apo vullnet qe ta mbuloje autorin e vërtete te krimi. Prandaj, opcioni se te Lugu i Isufit i pandehuri ne mënyre te rrejshme e ka akuzuar veten duhet te injorohet si një gjë qe vështire se ka ndodhur dhe eshte e papranuar.

Me tutje, duhet te vërtetohet nëse gjate procedurave penale kane dalur elemente tjera ne mënyre qe te vërtetohet rrëfimi jashtë gjyqësor.

Ne këtë pike, se pari qëndron fakti se derisa Galani kishte thene se ai e kishte vrare gruan, i kishte treguar ... një fletore shënimesh e cila ishte e viktimit dhe ne te cilën ishin te shënuara emrat dhe numrat e telefonave te disa personave Serb. Kjo është po e njëjta fletore qe është cekur nga ... ne deklaraten e tij dhe sipas asaj se çka ka thënë Galani te Lugu i Isufit, kjo ishte arsyeja e vrasjes (dëshmia e ..., procesverbali i datës 30.10.2009, faqja 8: dëshmia e ..., 17 Maj 2007, faqja 21).

Fletorja ashtë pare edhe nga ana e ... te Lugu i Isufit (Procesverbali i datës 16.05.2007, faqja 41).

Prezenca e fletores ne duart e Galanit te Lugu i Isufit është një element i qarte dhe objektiv i cili vetëton kredibilitetin e rrëfimit jashtëgjyqësor te bere nga ana e Idriz Gashit.

Një element tjetër vërtetues eshte rrethana se Idriz Gashi ka qene personi i cili bashke me ... ka shkuar nga Barani me Golf te kuq ne te cilin ka qene edhe Sanija dhe Barani është vendi ku Sanija është pare e gjalle para se te shoqërohet ne malin ku eshte vrare.

Nje element tjetër qe e vërteton rrëfimin është fakti se Idriz Gashi ka qene te Lugu i Isufit i armatosur me AK47 ne mënyre qe te varrose kufomën e viktimit duke i dhënë urdhër ... dhe duke i ndalur njerëzit per t'ju afruar vendit te varrimit. Ky involvim ne varrim është edhe një element tjetër vërtetues për te vlerësuar pozitivisht seriozitetin e rrëfimit te tij.

Ne opinionin e Trupit Gjykues rrëfimi dhe elementet e lartshënuara vërtetuese mendohen si te mjaftuar ne mënyre qe i pandehuri te shpallet pergjegjes per kryerjen e vrasjes se Sanije Balaj.

Me tutje, duhet te shtohet se pjesët e lartshënuara te dëshmisë, edhe pse te mjaftuara për te dënuar te pandehurin nuk qëndrojnë vetëm meçe gjate kursit te gjykimit kryesore janë shfaqur prova tjera.

Ne veçanti, dëshmia e ... edhe pse paraqet disa diskrepanca me deklaratat tjera (ai ka mohuar se e ka pyetur gruan, kurse ... qarte ka thënë se e ka bere këtë, ai e ka mohuar se e ka dërguar gruan ne mal bashke me Galanin, kurse ... ka thënë se i ka pare këta dy burra duke e shoqëruar ate grua ne mal) e edhe pse shihet qarte se ka qellim te ule involvimin e tij eventual ne vrasje, ajo përputhet me dëshmitë tjera ne lidhje me atë se çka ka thene Galani pasi qe është varrosur vajza (i.e. qe Galani e ka pranuar te Lugu i Isufit se e kishte vrare gruan:

shiko procesverbalin e datës 12 Nentor 2009, faqja 40) dhe është shumë e qarte dhe koherente në lidhje me rrethanën se Galani ka shtene në vajzën në mal dhe për njohjen e Idriz Gashit si Galan.

Në anën tjetër dëshmia e [] nuk është e sigurt sa i përket pjesës ku ai e ka përshkruar intervistën e viktimës në Baran. Deklaratë e tij kontradiktoret në mënyrë të zëshme nga versioni i dhënë nga [] i cili duhet të konsiderohet si i sigurt dhe me i besueshëm për shkak të rolit neutral të tij në ngjarje. [] qarte ka thënë se [] ka qenë prezent gjatë intervistës së viktimës në Baran bashkë me [] dhe Idriz Gashi dhe ka intervenuar disa here sa që [] është obliguar të pyes atë (dhe []) që të lëshojë dhomën.

Me tutje, dëshmia e [] nuk është e sigurt kur ai njofton ngjarjet të Lugu i Isufit gjersa viktima ende ishte gjalle. Faktikisht, ai mohon se e ka shoqëruar gruan deri në mal dhe thotë se ai ka qëndruar në veturë gjersa vetëm Idriz Gashi e udhëhiqete viktimën drejt malit.

Kjo pjesë e dëshmisë zëshëm kontradiktoret nda dëshmia e [] i cili është shumë i qarte (ajo është një nga disa rrethanat që i kujtohen dëshmitarit) kur thotë se personat që e kanë shoqëruar viktimën në mal ishin dy. [] gjithashtu sqaron se koha e kaluar ndërmjet momentit kur tre personat kanë hyrë në mal dhe momentit të shkretpjes së gjuajtjes ishte rreth tridhjetë minuta, ndërsa [] ka vërtetuar se kanë kaluar vetëm dy minuta.

Trupi Gjyqësor mendon se dëshmia e [] është me e besueshme për shkak të mosperzirisjes së tij në ngjarje e cila pa i marrë parasysh disa të metura në kujtesë (por lehte të sqaruara me moshën e re të dëshmitarit në atë kohë) duhet dhënë vërtetësinë e dëshmisë.

Prandaj, është evidente nga dëshmia e [] dhe [] se roli i [] në ngjarjet ka qenë i ndryshëm nga ajo që ai e ka përshkruar (ndryshe nga ajo se çka ka thënë se ai e ka marrë në pyetje viktimën dhe e ka shoqëruar atë në mal).

Përkundër, sa i përket varrosjes të Lugu i Isufit dhe fjalëve vete akuzuese të shprehura nga ana e Idriz Gashi, dëshmia e [] është pak a shumë konsistente me dëshmitë e [] dhe [], prandaj duhet të konsiderohen si të besueshme në lidhje me atë pjesë.

Gjithashtu edhe pjesa e dëshmisë në të cilën [] e akuzon Idriz Gashin për vrasjen e vajzës, edhe pse modalitetet duhet të kenë qenë të ndryshme nga ato të përshkruara nga ana e dëshmitarit, duket se janë koherente në brendësi dhe të vërtetuara nga rrëfimi i Idrizit.

Është e rëndësishme të theksohet rrethana se disa pjesë të dëshmisë së [] nuk janë të besueshme dhe nuk detyron mospërfilljen e tërësishme të dëshmisë së tij. Në fakt është parim i përgjithshëm se dëshmia mund të ndahet sa i përket besueshmërisë së saj, që do të thotë se Gjyqtari mund të pranojë disa deklaratë si të besueshme, sepse janë të vërtetuara nga elemente objektive dhe solide të vërtetimit, dhe të mospërfilljen deklaratat të cilat kontradiktoren nga element të sigurt.

Në fund, në mënyrë që të kemi vlerësim të mirë e të balancuar të ngjarjeve, duhet të konsiderohet versioni i paraqitur nga ana e dëshmitarit.

Versioni i lartpërmendur, edhe pse koherente nga brendësia e saj, paraqet disa kontradikta të zëshme me dëshmitë e dëshmitareve kryesore.

Se pari: i pandehuri gjithnjë ka qëndruar prane asaj se kur Sanije Balaj është ndalur nga ... ne Baran, ai e ka ofenduar vajzën me shume se një here dhe e ka thirrur atë spiune sikur te kishte diçka specifike kundër saj (duhet te kujtohet se sipas Idrizit ... e ka vrare vajzën).

Ky rikonstruksion del prej ekuilibrit nga ana ... , farefis i Sanijes, i cili ka qene bashke me te ne veture, i cili ka thëne se ... i ka ndalur ata dhe ne mënyre njerëzore ka thëne se duhet te flas me Sanijen, (shiko procesverbalin e datës 9.5.2007).

Se dyti: Çuditërisht ne versionin e dhëne nga Prokurori me 15 Nentor 2006, i pandehuri nuk e ceke emrin e ... si personin i cili e ka intervistuar Sanije Balaj, dhe përkundrazi, ka treguar ... si personin i cili e ka intervistuar viktimën dhe se ... ka kërkuar intervenimin e Idrizit. Edhe ai ka thëne se nuk e ka pare ... (faqja 11)

Veç kësaj, sipas te pandehurit (dhe poashtu ... pas intervistës së pare te Sanije Balaj do te kishte ndodhur një njëfarë interviste e dyte e viktimës e bere direkt nga ana e Idriz Gashit. Rrethana del nga ekuilibri nga ana e dëshmisë se ... i cili ka thene se e ka pare gruan duke hyre ne Golf me dy ushtaret vetem dy minuta pasi qe ka përfunduar intervistën me te dhe se Idrizi ka qëndruar i qete gjate intervistës. (shiko procesverbalin e intervistës se datës 14 Shkurt 2006, faqja 12: *PP: Sa kohe ka kaluar kur ke dale nga dhoma bashke me Sanije Balaj dhe kur e ke pare atë duke hyre ne Golf? ... : Dy minuta sepse distanca është e shkurte dhe pastaj ata është dashur te ecin ne këmbe afro 75 metra deri tek vetura. Une kam ecur me një shpejtësi normale sepse nuk kam qene ne nguti. Gjasat jane te mëdha se ata kane dalur nga dhoma menjëherë pas meje).*

Se Treti: Sipas versionit te dhene nga ana e te pandehurit pasi qe ka shkuar nga Barani me Golf te kuq ai ka arritur ne fshatin Pozhare dhe atje ai i ka dorëzuar ... vajzën dhe fletoren dhe është munduar te shkoje ne Gillogjan ne këmbe. Kjo ka qene hera e fundit qe ai e ka pare te gjalle Sanijen.

Prap, ky version kontradiktoret me dëshmitë e ... dhe ... te cilet kane thëne se te Lugu i Isufit, Galani pasi qe e ka pranuar vrasjen ju ka treguar atyre fletoren nga e cila i ka lexuar disa emra Serb.

... ka deklaruar se nuk ka pare kurrfarë fletore por Galani e ka përmendur një fletore ku kane qene te shënuar disa emra Serb (intervista para Prokurorit me 22.11.2006, faqe 5)

Me tutje, sa i përket fletores, i pandehuri ka thëne se para se te filloj intervista e Sanijes, ai i ka nxjerre gjerat nga çanta e dorës se Sanijes dhe i ka vendosur ato mbi tavoline dhe pastaj e ka pare fletoren, kurse sipas dëshmisë se ... , libra (fletorja) ka qene ne duart e intervistuesve (...) gjate intervistimit te bere nga ...⁶⁶ dhe se Fletorja vetëm ka qene ne duart e ... vërtetohet nga ... i cili ka thëne se është marre nga ... direkt nga vetura ku ka qene Sanija.⁶⁷

Veç kësaj, versioni i dhëne nga i pandehuri (sipas se cilit viktimja do te ishte vrare nga ... dhe se ai kurrë nuk e ka pranuar para njerëzve tjerë ne Lugu i Isufit) qëndron i izoluar pa asnjë pjese evidence e cila mund te vërtetoje ate.

⁶⁶ Deklarata e Cuf Krasniqit, 14 Shkurt 2007, faqe 9

⁶⁷ Deklarata e Policise se Hamdi Balaj, 21 Tetor 2002

Faktikisht, dëshmitaret e paraqitur nga i pandehuri, [redacted] (dëshmitë e dhëna nga ai para trupit gjykues ne gjykimin e kryesor me 24 Maj 2007 janë siguruar ne gjykimin kryesor ne baza te konsensusit te palëve) Jonuz dhe Ibrahim Maksutaj (ata janë ekzaminuar, respektivisht me 17 dhe 19 Nëntor 2009) janë krejtësisht te pavlere ne lidhje me vertetsine e versionit te te pandehurit dhe te zhvleftësoj versionin e dhëne nga dëshmitaret tjerë.

Ne veçanti, [redacted] është pyetur gjate gjykimit kryesor ne lidhje me deklaratën e tij para ish-avokatit te te pandehurit me 25.9.2008. Sipas asaj deklarate, rreth mesit te Gushtit, [redacted] e ka pare Sanije Balajn duke ecur afër barit te tij dhe i ka pyetur dy individë qe ta qojnë atë ne Gillogjan. Sa i përket përmbajtjes se kësaj deklarate, dëshmitari ka deklaruar (procesverbali i datës 19 Nentor 2009) se ai kurrë nuk e ka njohur [redacted] dhe se nuk ka ditur asgjë për episodin e ndodhur ne barin e Metes ne Gusht 2008 ne lidhje me atë vajze.

Prandaj, duhet te ngritët nje brengosje serioze dhe një dyshim për autencitetin e deklaratës se 25.9.2009, gjithashtu duke pasur parasysht modalitetet ne te cilat është dhëne deklarata (veç para avokatit te te pandehurit).

Për te gjitha arsyet e lartshënuara, versioni i propozuar nga ana e te pandehurit duhet te injorohet dhe te konsiderohet si i pavërtete. Ne anën tjetër, disa diskrepanca dhe mangësi te versionit te tij japin kontribut ne mundësinë e besimit te rikonstruimit qe e paraqet te pandehurin si keqbërësin e vrasjes.

Ne fund, sa i përket [redacted], është e pamohueshme se dëshmia e [redacted] qe tregon se Sanija është shoqëruar ne mal nga dy burra dhe fakti se krismat janë dëgjuar afro gjysme ore pasi qe tre njerëzit kane hyre ne mal te Lugu i Isufit (dhe jo pas dy minutave si qeshte cekur nga [redacted]) e bëjnë te qarte se [redacted] është përzier ne vrasje. Prandaj, pavarësisht mbarimin e hetuesisë qe është lëshuar koheve te fundit nga Prokurori, duke i marre parasysht dëshmitë e reja te dhëna gjate gjykimit te tanishëm kryesor, [redacted] duhet te denoncohet tek PSRK meqë ka dyshim te bazuar se ai e ka vrare Sanije Balajn ne kooperim me Idriz Gashin, prandaj kane kryer vepër penale te Krimeve te Luftes kundër Popullates Civile, ne kundërshtim me Nenin 142 te Kodit Penal te RSFJ, Neni 3 dhe 147 te Konventes se Katërt te Gjeneves dhe Neni 4 te Protokollit Plotësues II te Konventës se Gjenevës sa i përket vrasjes se Sanije Balaj e kryer te Lugu i Isufit ne afërsi te fshatit Vranoc, Komuna e Pejes me 12 Gusht 1998.

Prandaj një kopje e procesverbalit te Gjykimit te tanishëm kryesor do ti dërgohet PSRK-se.

Me tutje, për shkak te diskrepancave te larte cekura me dëshmitë tjera është e qarte se [redacted] e ka kryer vepër penale te Dhënies se Rrejshme te Deklaratës, ne kundërshtim me KPK, neni 307. Prandaj, procesverbali i dëshmisë do te dërgohet te Zyra e Prokurorit ne Komunen ne Pejes bashke me gjykimin e tanishëm ne mënyre qe te fillohet me hetuesinë kundër tij.

2. Parashitresat e Paleve

Avokati Mbrojtës i te Pandehurit i ka ngritur disa pyetje sa i përket cilësisë se [redacted], dhe veçanërisht se a duhej ai te konsiderohej si dëshmitar, si i bashke pandehur apo dëshmitar bashkëpunues.

Ne këtë pike, duhet të specifikohet se me 15 Tetor 2009, Prokurori ka lëshuar urdhër sipas nenit 224 të KPPK për përfundimin e hetuesisë kundër [] (fillimisht i dyshuar bashkë me Idriz Gashin për vrasjen e Sanije Balaj) por nuk i ka njoftuar palët e dëmtuara për këtë urdhër në mënyrë që ti lejoje ata të ushtrojnë të drejtën e ndjekjes penale siç njihet në nenin 62, par.1 dhe 2 të KPPK.

Gjate gjyqimit, është pare se Sanije Balaj ka pasur dy vëllezër ([] dhe []) dhe një motër ([]) dhe për shkak të definicionit të dhënë nga neni 151 të KPPK (*termi pala e dëmtuar dmth personi të të cilit u janë shkelur të drejtat personale dhe pronësore apo i janë rrezikuar nga vepra penale*) ka qene e pamohuar (duke mos marrë parasysh opinionin e kundërt të Prokurorit) se të gjithë është dashur të konsiderohen si pale të dëmtuara.

Para ekzaminimit të [] dhe [] kane deklaruar se nuk kanë pasur qëllim të shfaqin të drejtën e garantuar të palëve të dëmtuara sipas nenit 62 të KPPK kurse nuk ka qene e mundur të merret ansje deklarate prej [] (ai nuk është paraqitur dhe nuk i ka dhënë gjykatës kurrfarë deklarate formale) prandaj në momentin e ekzaminimit të [] ende ka pasur të drejtë të marrë përsipër lenden e ndjekjes penale kundër tij.

Megjithatë, pa marrë parasysh këtë, trupi gjykues ka arritur në përfundim se sipas parimit *tempus regit actum*, statusi momental i [] ka qene padyshim ai i dëshmitarit.. Faktikisht ai nuk ka mundur të kualifikohet si i dyshuar apo si dëshmitar meqë në kohën e intervistës së tij me 12 Nëntor 2009 nuk ka pasur as hetuesi momentale e as proces të vazhdueshëm penal kundër tij e as që mund të thuhet se autoritetet e ndjekjes penale kane pasur dyshim të arsyeshëm kundër tij (sipas definicionit për të dyshuarin dhe dëshmitarin të cekur në nenin 151, n 1 dhe 2 të KPPK)

Sa i përket termit *Autoriteti i ndjekjes penale* definicioni paraqitet në nenin 151 të KPPK duke thënë se këto autoritete mund të jene Prokuroria Publike apo Prokurori Privat apo ndonjë Prokurore ndihmës: Prandaj pala dëmtuese e cila nuk ka vendosur të filloj apo jo ndjekjen penale nuk mund të listohet në mesin e autoriteteve të ndjekjes penale meqë termi '*ndjekje ndihmese penale*' dmth Pala e Dëmtuar që ndërmerre ndjekjen penale dhe 'prokurori privat' dmth pala e dëmtuar e cila e udhëheqë ndjekjen penale.

Me fjale tjera, mundësia e thjeshte abstrakte se pala e demtuar mund të vendose të filloj ndjekjen penale kunder personit nuk i jep të drejtë personit të larteshenuar të supozojë pozicionin e autoritetit të ndjekjes penale. Ky lloj kualifikimi mund të sigurohet vetëm nese në të vërtete shfrytëzohen përpjekjet e të drejtës për ndjekje penale në vend të prokurorit.

Prandaj, meqë [] nuk e ka përdorur të drejtën e tij, [] nuk mund të definohet i dyshuar apo i pandehur.

Ky konkludim detyron se [] as që mund të kualifikohet si dëshmitar bashkëpunëtorë, meqë sipas Nenit 298 të KPPK, dëshmitari bashkëpunues do të thote i dyshuari apo i pandehuri i cili dëshiron të bashkëpunojë nën kushte të caktuara.

Vlen për tu cekur se sa i përket [], i kualifikuar si dëshmitar bashkëpunëtor nga Gjykata Supreme, situata ka ndryshuar sepse pas lëshimit të vendimit nga Gjykata Supreme, Prokurori, siç u tha me herët, ka lëshuar vendim për përfundimin e hetuesisë. Prandaj, kualifikimi i lartcekur nuk mund të konsiderohet me tutje si kualifikim detyrues.

Perseri, sa i përket [redacted], Avokati Mbrojtës ka ngritur një qeshtje tjetër, dhe ne veçanti ate se te gjitha deklaratat e mëparshme te tija është dashur te konsiderohen si te papranuara për shkak te kualitetit te tij si i dyshuar ne atë kohe.

Ne ate pike, trupi gjykues ka vendosur se deklarata e dhene nga [redacted] me 17 Dhjetor 2002 para policise eshte dashur te lihet anash meqe [redacted] eshte degjuar si i dyshuar dhe se ai nuk ka marre te gjitha vërejtjet te parapara ne nenin 218 te ligjit te procedures penale te Ish Republikes Jugosllave, ligj ky i cili ka qene ne fuqi ne ate kohe.

Sa i perket deklarates se [redacted] me 11 Gusht 2005, deklarate ne te cilen [redacted]

[redacted] eshte degjuar si dëshmitar, trupi gjykues ka qene i mendimit se deklarata eshte dashur te lihet anash meqe [redacted], edhe pse ende nuk ka pasur vendim per fillimin e hetuesise, ka qene i dyshuar ne ate kohe.

Sa i perket deklarates se dhene nga [redacted] me 30 Janar 2006, trupi gjykues ka menduar se per shkak te parimit *tempus regit actum*, se deklarata eshte dashur te lihet anash meqe ne ata kohe vendimi per fillimin e hetuesise kunder tij vetem ka qene i leshuar prandaj ai eshte degjuar si i dyshuar dhe i ka marre te gjitha vërejtjet e parapara nga ligji ne fuqi ne ate kohe.

Sa i perket deklarates se dhene nga [redacted] me 16 Maj 2006, trupi gjykues e ka konsideruar veten te detyruar ne vendimin e leshuar nga Gjykata Supreme se deklarata nuk eshte dashur te konsiderohet si e papranuar dhe se vetem kriteri i gjykimit i stilizuar nga gjykata e shkalles se pare nuk ka qene korrekt meqe dëshmitari eshte dashur te kete qene vleresuar si dëshmitar bashke punues.

Avokati Mbrojtes gjithashtu ka pyetur per përjashtimin e deklarates se dhene nga [redacted] para Prokurorit me 28 .12. 2005 per te cilen fillimisht, ai ka dhene pëlqimin ne menyre qe te siguroj ate sipas nenit 368 te KPPK.

Ne ate pike, avokati ka pohuar se deklarata eshte dhene ne shkelje te nenit 6 par.3, pjesa c e Konventes Europiane per te Drejtata e Njeriut (orig.ECHR) dhe nenit 153 te KPPK.

Ne te vertete, u hetua se Prokurori duke vepruar ne kapacitetin e tij si Prokuror i UNMIK e ka marre deklaraten ne SHBA pa bere kerkese paraprake per Ndhime Ligjore Nderkombetare e cila eshte dashur ti adresohet autoriteteve kompetente sipas nenit 507 te KPPK. Prandaj, Prokurori nuk ka pasur kurrfarë te drejte te ushtroje veprën e hetuesisë dhe si pasoje deklarata eshte konsideruar si e papranuar nga trupi gjykues dhe është përjashtuar ne baze te nenit 154 te KPPK.

Avokati Mbrojtes i te pandehurit ka paraqitur edhe ca pjese te deshmise te cilat jane deklaruar si relevante dhe te pa pranuar nga trupi gjykues gjate seances se 10 Nentorit 2009.

Ne veçanti, Avokati Mbrojtës ka pyetur trupin gjykues te ekzaminoje [redacted] si dëshmitar por kërkesa është refuzuar meqe nga deklarata e tij e mëparshme eshte pare e qarte se dëshmitari nuk ka ndihmuar drejtpërsëdrejti ne ngjarjet ne Baran dhe te Lugu i Isufit, dhe se dëshmia e tij ka qene e tepruar ne rastin konkret.

Me tutje, Avokati Mbrojtes ka kërkuar konfrontim ndermjet tre deshmitareve ([redacted] dhe [redacted]) per shkak te diskrepancave ne deshmite e tyre: trupi gjykues ka refuzuar kerkesen duke e paraqitur ate te tepruar dhe te panevojshme: ne fakt, edhe pse ka qene e vertete se ka pasur ca diskrepanca, ne anen tjetër dëshmitari i lartepemendur vetem i ka dhene disa deklarata gjate fazave te mëparshme te procedures, gjithnjë duke thene pak a shume versionin e njejte te

ngjarjeve: Prandaj, ka pasur shuma pak gjasa qe deshmitaret kane mundur te nderrojne versionin e tyre te mëparshëm per shkak te konfrontimit.

Ne fund Avokati Mbrojtes ka kërkuar te perjashtoje aktakuzen kunder Ramush Haradinaj *et alii* te paraqitur me TPNJ (Tribunali Ndërkombëtar per ish Jugosllavine) dhe te paraqitur ne gjykimin e tanishem kryesor nga Prokurori Publik i EULEX ; Kërkesa eshte refuzuar sepse aktakuza e shenuar me larte eshte marre edhe me vrasjen e Sanije Balaj, prandaj eshte konsideruar e lidhur dhe relevante me specifikat, se relevanca e larteshenuar eshte e mbyllur ne faktin se aktakuza qe merret edhe me vrasjen e Sanije Balaj eshte paraqitur ne TPNJ.

Per te njëjten arsye, trupi gjykues *ex officio* ka siguruar vendimin e leshuar nga TPNJ ne rastin e Ramush Haradinaj *et alii* me 3 Prill 2008, dukle specifikuar se vendimi i larteshenuar nuk ka qene final dhe relevanca e tij ne rastin konkret eshte përmbyllur ne rrethanat faktike sepse nje vendim i cili gjithashtu eshte marre me rastin e Sanije Balaj eshte leshuar nga TPNJ.

Palet e dëmtuara nuk kane paraqitur kurrfare arsyetimi.

F. KUALIFIKIMI LIGJOR

1. Vleresimi ligjor i fakteve nga Gjykata

Jurisprudenca konstante per Krimet e Luftes gjate viteve ka percaktuar se cilat jane kushtet qe e hetojne pergjegjesine penale te te akuzuarit: ne veqanti, minimumi i ketyre kushteve duhet te vertetohen:

- ekzistenca e konfliktit te brendshem te armatosur dhe natyra detyruese e ligjit aplikues nderkombetar mbi palet;
- pjesemarrja e te akuzuarit ne konflik te armatosur
- lidhja ndermjet krimit te pandehur dhe konfliktit te armatosur:
- statusi (mbrojtes) civil i viktimes:
- se sjellja ne fjale eshte ne kundërshtim me ligjin nderkombetar efektiv ne kohen e sjelljes, dhe gjithashtu bie brenda atyre veprave penale te identifikuar si krime te luftes brenda Nenit 142 (i ashtuquajture testim dual);
- pjesemarrja e te akuzuarit ne vepren penale.

Ekzistenca e konfliktit te brendshem ushtarak dhe natyra detyruese e ligjit nderkombetar aplikues mbi palet;

Konflikti i armatosur ekziston kur behet perdorimi i forces se armatosur ndermjet shteteve apo ndermjet dhunes se zgjatur te armatosur ndermjet autoriteteve qeveritare dhe grupeve te organizuara ushtarake. Ligji nderkombetar humanitar (LNH) aplikohet qe nga fillimi i konflikteve te tilla dhe vazhdon pertej ndaljes se armiqesive derisa arrihet nje konkluzion i pergjithshem i paqes.

Ne rast te konfliktit te armatosur nderkombetar, civilet, personat e njohur si hors de combat dhe jo te armatosurit jane te mbrojtur nga parimet baze te LNH, ne veqanti

nga Konventa e Gjeneves e vitit 1949 dhe Protokoleve Shtese te 1977. Ne rast te konfliktit te brendshem ushtarak, personat e njejte kane te drejte per mbrojtje sipas Nenit 3, i zakonshem per te kater shtesat e Konventes se Gjeneves nga Protokoli Shtese II (me tutje CA3 dhe APII).

Ne menyre qe te konsiderohet konflikt ushtarak nen CA3 kriteri esencial eshte qe dhuna e vazhduar ushtarake te ndodhe ndermjet autoteteve ushtarake dhe grupeve te armatosura ose ndermjet drupeve te tilla brenda shtetit. APII e plotëson kete duke kërkuar qe keto grupe te jene nen komande te përgjegjshme dhe te ushtroje kontrolle te tille mbi ndonje ndonje pjese te territorit te shtetit per ti mundësuar ato te kryejne operacione ushtarake te qëndrueshme dhe te perbashketa dhe se armiqesite te ndodhin ne nivelin qe tejkalon ate qe mund te karakterizohet thjeshte si rremuja dhe tensione, si trazira te izoluara apo akte sporadike te dhunes dhe akte te natyres se ngjashme.

Nuk kontestohet nga palet dhe mund te konsiderohet si fakt i njohur shume mire se ne Gusht 1998 ka ekzistuar nje konflikt i armatosur qe ka involvuar UÇK-ne dhe Forcat Jugosllave/Serbe te cilat mund te konsiderohen si konflikt i brendshem i parashikuar nga CA 3 dhe AP II.

Si ne kete pike do te ishte e mjaftuar te citohen disa raporte ne lidhje me ekzistencen e konfliktit te armatosur ne ate periudhe.

Raporti i OSBE-se i quajtur "Kosova: Te Flitet, Sic Shifet" (qe gjendet edhe ne internet) ofron nje pasqyre per ngjarjet dhe zhvillimet kryesore per armiqesite ne Kosove gjate viteve 1998 dhe 1999. Raporti i larte cekur i OSBE-se (Pjesa 1, Permbledhje Ekektive fage 4) thote se "*Deri ne fillim te 1998, natyra e situates ne Kosove ka ndryshuar. Nje element ka hyre ne ekuacion ne forme te Ushtrise Çlirimtare te Kosoves(UÇK) dhe se Autoritetet Serbe ishin fajtores me rritjen e madhe te forces ushtarake*" i njejti pasazh vazhdon pak me tutje "*Autoritetet Serbe kane futur forca speciale te sigurise ne janar 1998. Ata ju përgjigjen konflikteve me UÇK me sulme represalje neper fshatra duke përdorur helikoptere dhe autoblanda ushtarake te shoqeruara nga sulme brutale neper shtëpia dhe duke kryer arrestime te paskrupullta. Dy arrestime te tilla neper fshatra jane percjellur nga sulme ne Prekaz te Ulet (Komuna e Skenderajt) ne fillim te Marsit, ku se paku 54 njerëz jane vrare duke e perfshire edhe udheheqesin lokalte te UÇK-se, shumica e familjes se tij dhe gra te tjera, femije dhe pleq. Represaljet kane vazhduar me sulme tjera ne fshatra ne regjionin qendror te Drenices duke i detyruar fshataret te leshojne shtëpite e tyre. Ne kete spirale renese te dhunes, shume Kosovare Shqiptar duke perfshire edhe perkrahesit paqesore te LDK- se u bene antare te UÇK-se dhe simpatizues aktiv*" Pasazhi i njejte gjithashtu ceke se "*Perforcime substanciale ushtarake Serbe ishin derguar ne Kosove ne Maj te vitit 1998*" dhe se "*nje vërejtje e forte e fundit*" nga Qeverite Evropiane ne Qershor ishte injoruar kur forcat Serbe ishin koncentruar ne regjionin e Drenices dhe pergjate kufirit jug-perendimor duke përdorur Artilerine per te detyruar fshataret te ikin nga shtëpite e tyre, dhe pastaj duke i plaçkitur dhe djegur ato.

Pjesemarrja e te akuzuarit ne konflikt te armatosur.

Pjesemarrja e te akuzuarit ne konflikt te armatosur eshte e pamohuar. I pandehuri ka pranuar se ne Gusht 1998 ka qene anetar i UÇK-se (ne fakt ai e ka leshuar Suedine ne Qershor 1998 dhe menjehere pastaj ju eshte bashkangjitur UÇK-se; e pastaj rreth

Gushtit 1998 ka shkuar ne Shqiperi; intervista para Prokurorit, 15 Nentor 2006, faqet 5-6).

Nexus

Konflikti i armatosur ka luajtur nje rol fundamental ne mundesine e te Pandehurit per te kryer krimet. Vendimi i Idriz Gashit per te vrare Sanije Balaj ka qene qarte i lidhur me Konfliktin. Faktikisht arsyeja e supozuar per veprimet kunder viktimes ka qene per shkak te bashkepunimit te supozuar me Serbet. Idriz Gashi e ka perdorur poziten e tij te antarit te UÇK-se ne menyre qe te mundesoje ate te hyje ne Golf te kuq, te obligoje ate te hyje ne mal dhe ne fund te shtie ne te. Gjithashtu edhe sqarimi i dhene nga Galan te Lugu i Isufit sa i perket arsyes pse eshte kryer vrasja, (ai e ka treguar fletoren e Sanije Balaj) qarte tregon se vajza eshte ekzekutuar sepse eshte menduar se ka qene bashkepunetore e Serbeve.

Statusi i viktimave

Neni 142 i KPJ (orig.CCY) kerkon qarte qe viktima te jete pjese e popullates civile. Ne rastin e konfliktit te brendshem, IHL permes parashtresave CA3 dhe AP11 i mbrone te gjitha personat te cilet nuk jane te armatosur dhe te cilet nuk marrin pjese direkte ne armiqesi. Personi Civil definohet personi i cili nuk merre pjese aktive ne armiqesi me qellim qe te shkaktoje lendim fizik personelit armiqesor apo objekteve.

Neni 5 i Konventes se IV te Gjeneves thote se, per personin civil te humbe statusin e tij/saj si person i mbrojtur ai/ajo duhet "*definitivisht te dyshohet per.....aktivitete qe jane armiqesore kunder Shtetit...*"...dhe Kolegji konkludon se vete fakti qe Sanije Balaj ka pasur nje fletore me vete me numra telefoni te disa personave Serb te shkruar ne ate nuk mund te konsiderohet si dyshim i kryerjes se aktiviteteve armiqesore.

Shkelja e Ligjit te Brendshem dhe Nderkombetar ne fuqi ne kohen e kryerjes (i ashtuquajtur i testim dual);

Neni 142 i KPJ (orig.CCY) thote se definicioni primar i sjelljes se ndaluar duhet te gjendet ndermjet veprave themelore penale te cekura ne Nenin 142. Se dyti, nje veper e tille penale duhet te perbeje shkelje te Traktateve Nderkombetare. Jugoslavia e ka ratifikuar Konventen e Gjeneves dhe te dy Protokolet Shtese. Sa i perket veprave te kryera ne konfliktet e brendshme te armatosura, vepra duhet te kryhet ne shkelje te CA3 dhe/apo AP II.

Duke i pasur parasysh faktet dhe rrethanat e ketij rasti, eshte rezultuar si fakt se i pandehuri e ka kryer vrasjen e Sanije Balaj, prandaj kjo sjellje duhet te merret ne konsiderate me menyre qe te plotesohen kushtet per te ashtuquajturin testim dual.

Sa i perket vrasjes, duhet te ceket se kjo sjellje eshte e kufizuar edhe nga Neni 3, i zakonshem per te kater Konventat e Gjeneves, dhe nga Neni 4, par.2 i AP II dhe nga Neni 142 i KPJ (orig.YCC). Prandaj kerkesa e testimi dual eshte plotesuar.

Eshte rasti te ceket se nga rikonstruimi faktik i ngjarjeve te shenuara me lart shihet qarte se vrasja eshte bere me qellim, prandaj ne kete rast nuk mund te ngriten kurrfare dyshime per ekzistencen e *actus reus* dhe te *mens rea* sa i perket te pandehurit.

Pjesemarrja e te akuzuarit ne veprat penale

Pjesemarrja e te pandehurit ne veprat penale per te cilat ai eshte shpallur fajtor eshte diskutuar me para ne kete argumentim. Siq eshte shenuar me lart, Gjykata eshte e bindur mbi dyshimin e arsyeshem te kryerjes se vrasjes se Sanije Balaj nga ana e te pandehurit.

G. PERCAKTIMI I DENIMIT

Kur vendosen sanksione penale, gjykata duhet te kete parsasysh edhe qellimin e pergjithshem te denimit – dmth te shtypen aktivitetet e rrezikshme sociale duke i larguar te tjeret qe te shkaktojne vepra te ngjajshme penale – dhe qellimi specifik per te menjanuar te pandehurin te kryej prape vepra penale.

Ne kete rast Kolegji ka arritur ne perfundim se kjo ka qene nje veper brutale dhe e rende penale kunder nje personi civil te popullates qe eshte kryer nga nje person i armatosur rende. Sa i perket rrethanave te renda, duhet te ceket se per shkak te modalitetit te vrasjes, vdekja e Sanije Balaj duket te jete nje lloj ekzekutimi i kryer ne menyre brutale kunder nje personi te paarmatosur qe nuk ka pasur mundesi te mbroje veten. Sa i perket rrethanave argumentuese, duhet te merret ne konsiderate sjellja e shkelqyer e te pandehurit gjate gjykimit kryesor.

Koha e kaluar ne paraburgim (duke perfshire kohen e kaluar ne paraburgim ne Suedi duke pritur ekstradimin ne Kosove per veprat e larteshenuara penale) dhe ne arrest shtepiak nga ana e te pandehurit duhet te pranohen ne denim sipas Nenet 391.par (1), nenpar. 5, Neni 531, Par 4 dhe Neni 278 Par 7 i KPPK-se.

Meqe i akuzuari Idriz Gashi eshte shpallur fajtor, ai duhet ti paguaj shpenzimet e procedures penale ne perjashtim te interpretimit.

H. SHPENZIMET

Meqe i akuzuari Idriz Gashi eshte shpallur fajtor ai duhet ti paguaj shpenzimet e procedures penale me perjashtim te interpretimit (KPPK, neni 102, par 1). Gjykata do te merre nje vendim te veqante per shumen e shpenzimeve pasi te merren te dhenat e tilla.

I. KERKESA PER KOMPENZIM

Ne fillim te gjykimit kryesor, paleve te demtuara ju eshte perkujtuar ne lidhje me mundesine e paraqitjes se kerkeses (mocionit) per te bere kerkese prone brenda procedures penale sipas KPPK, Neni 355, par 2, por ata kane deklaruar se nuk kane qellim te praraqesin kerkese prone.

Prandaj gjykata nuk eshte dashur te leshoje vendim specifik per kete qeshtje.

Keshilla juridike

Kunder ketij vendimi personat e autorizuar mund te paraqesin ankese ne forme te shkruar prane Gjykates Supreme te Kosoves permes Gjykates se Qarkut ne Peje brenda pesembedhete diteve nga data e sherbimit te ketij vendimi.

Procesmbajtesja

Kryetari i Trupit Gjykues

Valentina Gashi

Gianfranco Gallo

Perkthyer ne gjuhen shqipe nga versioni autentik ne gjuhen Angleze, nga:

Muharrem Halilaj EULEX1704 – Nga faqja 1 deri ne faqen 12 te versionit Anglisht

Ilir Venhari EULEX1703 – Nga faqja 13 deri ne faqen 26 te versionit Anglisht

Zeqir Shabani EULEX1705 – Nga faqja 27 deri ne faqen 38 te versionit Anglisht

Ne emer te perkthyesve



